



# UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË  
HIDROTEKNIKË MSc. 2021/2022 – 2023/2024



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA  
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY  
Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381-38-548 644 URL: [fna.uni-pr.edu](http://fna.uni-pr.edu) e-mail: [fna@uni-pr.edu](mailto:fna@uni-pr.edu)

---

Dekani

Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. \_\_\_\_\_

Prishtinë \_\_\_\_\_ 2021

---

## RAPORT I VETËVLERËSIMIT TE BRENDSEHEM RIAKREDITIMI I PROGRAMEVE STUDIMORE

PROGRAMI STUDIMOR: KONSTRUKTIV BSc. (2021/2022 - 2023/2024)

PROGRAMI STUDIMOR: HIDROTEKNIKË BSc. (2021/2022 - 2023/2024)

Hartues:

Prof.Ass.Dr. **Florim Grajçevci**, Dekan

Prof.Ass.Dr. **Hajdar Sadiku**, Prodekan

Prof.Ass.Dr. **Ymer Kuka**, Prodekan

Ass. MSc. **Enes Krasniqi**, Koordinator për zhvillim akademik

Programi studimor u punua në bashkëpunim me Udhëheqësin e programit studimor të nivelit Master:

programi Master Konstruktiv

Prof. Dr. **Naser Kabashi**, programi Master Konstruktiv, dhe

Dr.sc. **Milot Muhaxheri**, asistent

programi Master Hidroteknikë

Prof. Asoc. **Laura Kusari**, programi Master Hidroteknikë

MSc **Hana Shehu**, asistente

Prishtinë, Janar 2021

**FAKULTETI I NDËRTIMTARISË**  
**PROGRAMET E STUDIMIT MSc:**  
**HIDROTEKNIKË**

**RIAKREDITIM**

**VITI AKADEMIK 2021/2022 – 2023/2024**

**RAPORT VETËVLERËSIMI TË BRENDSHËM**

*Janar 2021, PRISHTINË*

## Tabela e përmbajtjes:

1. HYRJE	6
1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit .....	6
2.1. Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim: Master Konstruktiv MSc .....	11
2.2. Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim: Master Hidroteknike MSc .....	11
3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM	13
4. VLERËSIMI INSTITUCIONAL I PROGRAMEVE TË STUDIMIT .....	15
4.1. Programi i Studimit Konstruktiv Master Shkencor MSc.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.1. Misioni, objektivat dhe administrimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT-it për misionin, objektivat dhe administrimin: ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.2. Menaxhimi i cilësisë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.3. Staf i akademik, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional. ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>defined.</b>	
Analiza SWOT për stafin akademik, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.4. Përmbajtja e procesit arsimor .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit mësimor: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.5. Studentët .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT për studentët: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.6. Hulumtimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT për hulumtim: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.1.7. Infrastruktura dhe burimet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2. Programi i Studimit Hidroteknike Master Shkencor MSc.....	15
4.2.1. Misioni, objektivat dhe administrimi.....	15
Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën: .....	17
4.2.2. Menaxhimi i cilësisë.....	19
Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë: .....	22
4.2.3. Staf i akademik .....	23
Analiza SWOT për stafin akademik: .....	25
4.2.4. Përmbajtja e procesit arsimor .....	26
Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor: .....	31
4.2.5. Studentët .....	33
Analiza SWOT për studentët: .....	37

4.2.6. Hulumtimi.....	38
Analiza SWOT për hulumtim: .....	38
4.2.7. Infrastruktura dhe burimet .....	40
Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:.....	42
4.5. Studentet – te dhenat .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.6. Hapesirat dhe paisjet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.7. Plani i Buxhetit dhe financimi per FN DHE FA .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.8. Struktura e Anekseve te bashkelidhura ne format elektronik (per verzionin final te RVV-se ne CD)	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## **1. HYRJE**

### **1.1. Një vështrim i shkurtër i Institucionit**

Fakulteti i Ndërtimtarisë (FN) është njësi akademike e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" institucion publik i arsimit të lartë, i cili zhvillon dhe organizon programe të studimeve universitare, punën e lartë shkencore dhe profesionale. Roli kryesor i një njësie akademike moderne për shoqëri demokratike është që të sigurojë ngritje shkencore dhe arsimore profesionale duke i përcjellur zhvillimet bashkëkohore shkencore në fushat përkatëse të studimeve.

## **2. MISIONI DHE OBJEKTIVAT, PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA**

Misioni i FN-së është i bazuar në misionin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e veprimeve akademike, hulumtimeve, punës shkencore dhe të krijojë kuadro profesionale të arsimit të lartë për tregun e punës për fushat e inxhinierisë së ndërtimit në pajtim me interesat strategjike dhe zhvillimore të vendit.

Mësimdhënia dhe kërkimet shkencore, paraqesin veprimtarinë kryesore të kësaj njësie akademike. Veprimtarinë e një njësie akademike e karakterizon bashkëveprimi ndërmjet veprimtarisë mësimdhënëse dhe asaj kërkimore-shkencore. Kjo, për faktin se, për arritjen e rezultateve të dëshiruara në studime, mësimdhënia duhet të jetë e pa ndarë nga puna kërkimore shkencore.

Në kuadër të aktiviteteve që zhvillon FN-ja, fokusi qëndron në këto orientime dhe arritje:

- mësimdhënie - mësimnxënie, që njehohësisht numërohet si një nga dy veprimtaritë kryesore,
- kërkime të vazhdueshme shkencore në shërbim të shoqërisë dhe vendit në përgjithësi,
- kuadro profesionalisht kompatible me kërkesat e tregut,
- aktivitete në fusha të nevojshme për kërkesat e tregut dhe
- ofrimi i shërbimeve dhe ekspertizave për palet e treta
- hulumtime në zhvillimin e patenteve nga ana e personelit akademik.

Qëllimi i FN-së është që të ketë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë dhe gjithashtu të krijojë dhe të mbështes standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me fokus permanent në kërkimet shkencore në fushën e inxhinierisë së Ndërtimit. FN-ja kërkon t'u përshtatet Standardeve Evropiane dhe të integrohet plotësisht në zonën Evropiane të arsimit të lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.

Vizioni i FN-së është të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë dhe të transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, po ashtu të ofrojë mundësi për të gjithë banorët e Kosovës për të përfituar nga ky arsim gjatë gjithë jetës së mësimi tërëjetësor pa kufizime.

Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve në njësi akademike arrin të parapërgatitë studentë për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht, niveli universitar krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta, përmes njohurive lehtësisht të transferueshme në disiplina të përafërta.

Në Fakultetin e Ndërtimtarisë organizohen programe të studimeve të niveleve BSc dhe MSc, ndërsa aktualisht nuk organizohen programe të Doktoratës. Programet e studimeve të klafisikuara të FN-së në Departamente dhe nivele janë sikur:

- Konstruktiv (BSc), dhe (MSc)
- Hidroteknikë (BSc), (MSc)
- Gjeodezi (BSc), (MSc), dhe
- Bachelor Inxhinieri e Ambientit (BSc)

Programet studimore Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit, në mënyrë të përgjithshme përbëhen nga grupi i lëndëve të përgjithëshme, lëndët me karakter formues profesional, lëndët integruese, profesionale, plotësuese dhe punimi i temës së diplomës të nivelit Master e cila është e bazuar në aplikimin e njohurive paraprake dhe në hulumtime paraprake.

Tërësia e krediteve të parapara për përfundimin e Programeve Bachelor në Departamentet: Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit është grumbullimi i 180 ECTS krediteve, përfshirë edhe punimin e diplomës, në kohëzgjatje minimale prej 3 vitesh (6 semestra). Tërësia e kredive të parapara të Masterit në: Gjeodezi, Konstruktiv dhe Hidroteknikë, është grumbullimi i 120 ECTS kredive, përfshirë edhe punimin e Masterit, në kohëzgjatje prej 2 viteve (4 semestra).

- **Udhëheqja, strukturat e menaxhimit, personeli akademik dhe administrata.**

Universiteti i Prishtinës ka Statutin [A1] ku përfshihen njësitë akademike si pjesë përbërëse, dokumente relevante për ndihmesë të njëjësive akademike, ka organet kolegjiale duke fillue nga Keshillin Drejtues, Senati, komisione funksionale të tjera, stafin menaxhues dhe administratën qendrore. Të gjitha këto FN i shfrytëzon për të organizuar dhe zhvilluar veprimtaritë akademike, hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimeve, mësimdhënien dhe mësimnxënien, duke pas në qendër të vëmendjes studentin.

Dekani i Fakulteti i Ndërtimtarisë, sipas statutit të UP-së është udhëheqës i cili krijon një mjedis kolegjial, bashkëpunues dhe studimi që i shërben interesave të përbashkëta të studentëve, profesorëve, stafit menaxherial dhe administrative. Detyrat e dekanit të IAL janë të përshkruara edhe në dokumentet relevante të nivelit qendror të UP-së, (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/126A0EED-0A53-48A7-8E56-5875EE868FAC.pdf>) [A6]. IAL, përkatësisht FN ka një strukturë të ndërtuar dhe të qëndrueshme të menaxhimit. Janë të zgjedhur dy anëtar nga stafi akademik me kontratë të rregullt pune në cilesinë e prodekanit. Prodekanët kanë detyrat e ndara dhe të përcaktuara mirë. Njëri nga prodekanët është përgjegjës për fushat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, çështjeve organizative me studentë dhe çështjeve organizative të njësisë akademike ndërsa prodekanit tjetër është përgjegjës për çështjet financiare dhe infrastrukturën e institucionit. Mbështetur në Statutin e UP-së, Dekani organizon departamentet të cilat marrin përgjegjësitë nga Dekani dhe sipas dokumenteve relevante të UP-së dhe të FN-së.

Në kuadër të FN-së ekzistojnë Departament të cilat korrespondojnë me fushat e studimeve përkatëse me programe studimore të veçanta të nivelit Bachelor dhe Master shkencor. Departament e FN-së, janë <https://fna.uni-pr.edu/Departamentet.aspx>:

- Departamenti i Konstruksioneve,
- Departamenti i Hidroteknikës,
- Departamenti i Gjeodezisë, dhe
- Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit

Funksionimi i departamenteve, në vijën vertikale nënkupton pjesëmarrjen e stafit akademik në vendimmarrje deri te Këshilli i njësisë akademike përkatësisht Dekanit të fakultetit. Për kompetencat e FN nga UP-ja vendimet merren në Këshillin e Fakultetit përkatësisht Dekani i Fakultetit.

Administrata e UP-së është e centralizuar dhe ofron shërbim të gjitha njësive akademike lidhur me shumë çështje, sikur mund të numërohen disa nga to: financat, shërbimet për studentët (diplomat, etj.), kontratat e personelit akademik dhe administrativ. Administrata e Fakultetit është me kompetenca të kufizuara ekzekutive dhe për Fakultetin e Ndërtimtarisë ajo përbëhet nga Sekretari, si funksioni më i lartë dhe përgjegjës për administratën në nivel të njësive akademike, shërbimi për studentët, TI -personeli, ekonomisti – financieri, shërbimi i protokollit, menaxheri i aseteve dhe laborantëve.

- **Studentët, fushat përkatëse kontekstuale të veprimtarisë së institucionit**

Fakulteti i Ndërtimtarisë ofron programe të studimeve bashelor BSc për fusha të ndryshme të studimeve (Konstruksione, Hidroteknikë, Gjeodezi dhe Inxhinieri e Ambientit), mbështetur në Statutin e UP-së dhe sipas KKK Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve ([https://akkks.rks.gov.net/uploads/korniza\\_kombetare\\_e\\_kualifikimeve\\_2020.pdf](https://akkks.rks.gov.net/uploads/korniza_kombetare_e_kualifikimeve_2020.pdf)), që ju dedikohen kandidatëve nga Republika e Kosovës të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm sipas kornizës nga MASHT-i për arsimin e mesëm dhe kandidateve nga vendet tjera sipas kotave të aprovuara <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/AEE5CABB-5CD7-4418-9489-03949385902A.pdf>. Për regjistrimin e studentëve të ri në programet e studimeve themelore në FN, shpallet konkursi nga UP-ja <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/308524D5-4D04-418C-B904-A574F890E195.pdf> duke specifikuar të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja organizon provimet sipas kritereve dhe vlerëson provimet, suksesin nga shkolla e mesme, provimi i maturës dhe bënë rangimin e tyre duke i shpallë në faqen elektronike të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate të sajë.

IAL organizon programe të studimeve edhe të niveleve Master shkencorë nga fushat e njëjta të programeve të studimeve nga BSc (Konstruktiv, Hidroteknikë dhe Gjeodezi). Programet e studimeve ju dedikohen studentëve të cilët kanë përfunduar studimet themelore dhe që kane mbërritur numrin e krediteve prej 180 ECTS nga studimet BSc të fushave përkatëse. Për regjistrimin e studentëve të ri në programet e studimeve Master gjithashtu shpallet konkursi publik nga Universiteti i Prishtinës ku specifikohen të gjitha kriteret dhe kuotat. Pas shpalljes së konkursit, FN-ja organizon provimet sipas kritereve dhe vlerëson provimet, suksesin nga niveli i studimeve themelore, dhe bënë rangimin e tyre duke i shpallë në faqen elektronike të fakultetit si dhe në hapësirat adekuate të sajë.

Fakulteti i Ndërtimtarisë ka rolin kryesor mësues dhe mësues, ku gjatë gjithë kohës ka në qendër të vëmendjes studentin. Përsosja e mësimit arrihet përmes punës kërkimore hulumtuese që realizohet nga personeli akademik i IAL-së. Angazhimi i personelit



akademik në fushat e hulumtimeve është prezent jo vetëm në vend, mirëpo edhe jashtë vendit duke dhënë kontribut shkencorë në konferenca shkencore me punime shkencore të publikuara edhe në revistat më prestigjioze në botë të fushës. Bashkëpunimet e FN-së me institucionet arsimore në vend dhe jashtë vendit janë inspirim për menaxhmentin dhe personelin akademik, gjithashtu kontributet institucionale dhe të personelit akademik për nevojat e tregut të punës janë evidente dhe numërohen si ngjarje e rëndomtë e Institucionit. Personeli akademik i FN jep kontribut të çmuar për shërbime të ndryshme të Fakultetit sipas kërkesave dhe mund të numërohen disa nga këto punë, sikur është edhe vet Raporti i vlerësimit të programeve të studimeve, hartimi i raporteve dhe analizave të ndryshme për nevojat e fakultetit. Prandaj, menaxhmetni i FN së bashku me stafin akademik dhe administratën janë të angazhuar jo vetëm në procesin e mësimit, mirëpo edhe në ngritjen e performancave të mësimdhënies, mësimdhënies, hulumtimeve shkencore dhe shërbimeve tjera të nevojshme për Institucionin.

#### - **Mësimdhënia, mësimi dhe kurrikula**

UP siguron studime baçelor, master dhe të doktoratës, sipas sistemit të Bolonjës përmes njësive akademike. Edhe pse Republika e Kosovës ende nuk është formalisht pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës, UP është një nga institucionet e para të arsimit të lartë në regjion që ka filluar reformat sipas këtij Procesi. Implementimi i reformave filloi në vitin akademik 2002/2003 dhe ende vazhdon. UP është i përkushtuar të arrijë objektivat e dala nga Deklarata e Bolonjës dhe deklaratat e komunikatave të Pragës, Bergenit, Berlinit dhe Londrës, dhe ka për qëllim të integrohet në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Universiteti ka rëndësi kryesore si sigures publik i arsimit të lartë në shoqërinë, komunitetin dhe ekonominë e Kosovës

Gjithashtu FN-ja vepron në vazhdueshmëri në fushëvepritaritë e veta si pjesë përbërëse e UP-së të arrijë qëllimet e përgjithshme të përcaktuara qartë.

Misioni i UP-së “për zhvillim të arsimit akademik, hulumtimit shkencor, kreativitetit artistik, këshillimit profesional” është i shoqëruar nga një grup prej 8 objektivave të detajuara, që ndikojnë qartazi ambicien e UP-së që të bëhet Universiteti Lider në Kosovë, të jetë aktiv në shoqëri, të krijoj dhe mbaj standardet më të larta në mësimdhënie, dhe mësim dhe hulumtim, dhe të jetë plotësisht i integruar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë si një universitet i njohur ndërkombëtarisht. Fakulteti i Ndërtimtarisë duke qenë pjesë e UP-së dhe pjesëmarrje në veprimet e saja akademike vepron qartazi duke pas të përcaktuar synimet e saja primare për arritshmërinë maksimale në mësimdhënie.

Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit.

Mekanizmat e mësimdhënies të cilat zbatohen në Institucion janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë mësimit, përvojës të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të institucionit si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në zërthimin e fenomeneve shkencore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, ndër të cilat "mësimdhënia një drejtimore" (nga pedagogu te studenti) duke nxitur studentin në pjesëmarrje

direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies pedagogun e vejnë në rolin primar jo vetëm të profesorit mirëpo edhe të moderatorit.

Stafi i Pedagogëve përgatitet gjithmonë me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies duke ju ofruar mundësia e pjesëmarrjes edhe nëpër trajnime permanente të ndryshme të organizuara në nivel të Universitetit <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,78>.

Në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies përcaktohet dhe organizimi i mësimdhënies, nëse ai do të jetë ligjëratë, ushtrime numerike, mësim praktik në terren ose edhe ushtrime laboratorike. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën mësimore. Rëndësi të veçantë ju jepet lëndëve të cilat ushtrojnë vizitat praktike në terrene si dhe ushtrimeve laboratorike duke demonstruar edhe shembuj praktik nga realiteti.

Veçori e Institucionit është monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimdhënësve gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Këtë monitorim e përcjellë vlerësimi i të gjithë mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit të vlerësuar nga studentët [A52]. Përmes instrumenteve të vlerësimit të mësimdhënies arrihet cilësia më e lartë e nxënies.

Secila lëndë mësimore ka literaturën e sajë themelore sipas syllabusit dhe literaturën e obliguar dhe të preferuar të cilën Studenti mund ta gjejë ose mësimdhënësi ju siguron paraprakisht.

Kurikulat e programeve të studimeve si atyre themelore ashtu edhe studimeve master kanë koncept përmbajtësor duke pas për bazë parimet themelore të formimit të programit të studimit nga formimi i grupit të lëndëve të përgjithshme informuese, pastaj grupi i lëndëve teorike shkencore si dhe grupi i lëndëve përmbajtësore të profesioneve të ngushta nga të cilat dalin edhe kompetencat e veçanta të studentëve pas përfundimit të studimeve.

## 2 PROGRAMET E STUDIMIT

### 2.1. Një vështrim i shkurtër i programit në vlerësim: Master Hidroteknike MSc

Departamenti i Hidroteknikës është pjesë përbërëse e Fakultetit të Ndërtimtarisë. Departamenti ofron Programe të studimeve për nivelin Bachelor BSc dhe Master MSc, që kanë për qëllim të sigurojnë ngritje arsimore profesionale në përputhje me zhvillimet shkencore në fushat e studimeve teknike të Hidroteknikës. Veprimtaria e këtij departamenti bazohet në një ndërlidhje në mes të mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore, për arritjen e rezultateve të larta në studime. Njëkohësisht, kjo veprimtaria do të krijojë kuadro profesionalisht të përgatitura dhe compatibile me kërkesat e tregut. Për të siguruar këtë qëllim të arritshmërisë, në programin studimor të Hidroteknikës është angazhuar personeli mësimor me kualifikime të duhura dhe përvojë si në mësimdhënie po ashtu edhe në kërkime shkencore.

Duke qenë pjesë e FN-së, edhe programet e BSc dhe të MSc në Hidroteknikë mirëpo edhe departamenti zbaton të gjitha standardet, kriteret, politikat dhe rregulloret e Fakultetit të Ndërtimtarisë përkatësisht Universitetit të Prishtinës.

Duke qenë se trendi i zhvillimit të vazhdueshëm të vendit tonë është duke shënuar rritje atëherë si rezultat i zhvillimit të degëve të caktuara të ekonomisë dhe industrisë paraqitet edhe urbanizimi i përshpejtuar. Në të njëjtën kohë janë rritur kërkesat për resurse natyrore dhe sidomos për ujë. Pos kërkesave në rritje të furnizimit me ujë gjendjen e bëjnë edhe më të rëndë rritja e kërkesave të popullsisë duke u bazuar në rritjen e cilësisë së jetesës, kërkesat e shtuara për ujitje, shfrytëzimi i fuqisë së ujit për energji, urbanizimi i intensifikuar dhe ndryshimet klimatike. Për më shumë, pos kërkesës në rritje të sasisë së ujërave duhet pasur parasysh edhe ndotjen e vazhdueshme të tyre dhe degradimin e kualitetit të resurseve ujore. Rritja e kërkesës për ujë dhe degradimi i kualitetit të ujit paraqet një barrë të vazhdueshme për resurset ekzistuese ujore. Prandaj, është më se e nevojshme që këto resurse të shfrytëzohen në mënyre optimale dhe të jemi të përkushtuar në mbrojtjen e tyre.

Të gjitha këto janë tregues të qartë se fusha e Hidroteknikës ka nevojë për personel të kualifikuar i cili do të ketë aftësi profesionale dhe shkencore për planifikimin optimal, projektimin dhe operimin e sistemeve të resurseve ujore. Programi MSc Hidroteknikë, ka për qëllim të thellojë njohuritë duke zbatuar aftësitë e fituara gjatë studimeve të nivelit Bachelor, në fushën e Inxhinierisë hidraulike, hidrologjisë dhe resurseve ujore në përgjithësi. Ky program fokusohet poashtu në zhvillimin dhe menaxhimin e resurseve natyrore dhe ujë rrjedhave, kualitetin e tyre përgjatë rrjedhjes si dhe në adresimin e karakterit multidisiplinar të aktiviteteve njerëzore që kanë të bëjnë me ujërat. Me këtë program të studimeve MSc Hidroteknikë pas përfundimit të studimeve do të përgatiten profesionistë për tregun e punës që kanë njohuri dhe aftësi të përmirësojnë menaxhimin e ndikimeve njerëzore në resurset tona ujore si dhe të zhvillojnë metoda për përmirësimin e efektit të ujërave të ndotura në ambient. Programi i studimit MSc Hidroteknikë përgatitë profesionistë që i përcjellin dhe përshtaten arritshmërive shkencore, ndryshimeve eventuale në fushat e ngushta profesionale si dhe risive teknologjike duke i plasuar ato në tregun e punës si në nivel vendor ashtu dhe ndërkombëtar.

Personeli i arsimuar në këtë fushë, do të mundësojë zgjedhjet më të mira të mundshme për resurset tona ujore dhe në të njëjtën kohë do të angazhohet për respektimin dhe përmbushjen e

kritereve ambientale. Për të adresuar këto sfida, programi studimor MSc Hidroteknikë, është projektuar me një çasje ndërdisiplinore dhe të integruar për të ofruar ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të qëndrueshme, plasman sa më të mirë për tregun e punës (duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës).

### 3. EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMI I KOHËVE TË FUNDIT I REGJISTRUAR QË NGA VLERËSIMI I MËPARSHËM

Njësia jonë akademike, në kohën kur është bërë ky vlerësim, ka qenë e organizuar me disa departamente ndër të cilat ishte edhe Arkitektura. Nga viti 2019, Institucionet vendimmarrëse duke mbështetë propozimin e njësisë akademike themelon Fakultetin e Arkitekturës. Nga viti 2019 e deri sot njësia jonë akademike paraqitet si Fakulteti i Ndërtimtarisë me katër departamente. Në dokumentet përcjellëse të cilat janë edhe bazë e realizimit të këtij Raporti të vlerësimit të brendshëm janë me nomenklaturën e FNA që ka funksionuar deri në 2019 pastaj janë vendimet, shkresat dhe dokumentet e fundit është nomenklatura me FN.

Në raportin e fundit të ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e programeve të studimeve (RVJ) MSc Konstruktiv dhe MSc Hidroteknikë të realizuar me 05 qershor 2017 janë dhënë disa rekomantime të cilat janë të radhitura sikur në vazhdim si dhe përpjekjet institucionale për plotësimin e tyre.

1. *Fusha për personelin akademik, ekspertët kanë rekomanduar që UP të qartësojë sistemin e avancimit profesional (p.sh nga profesor asistent në profesor të asocuar etj.). Po ashtu, ata rekomanduan që rasti ideal do të ishte që të gjithë mësime të jenë doktorë shkence.*

*Personeli mësues të vazhdojë të publikojë në revista ndërkombëtare të indeksuara në data bazat Thomson and Reuters dhe Scopus.*

Statuti i Universitetit të Prishtinës, nenet 182 deri 184 [A1], sqarojnë sistemin e avancimit të personelit akademik nga Profesori asistent, Profesori i asocuar deri tek Profesori i rregullt. Stafit akademik nga riakreditimi i fundit ka avancuar me grada shkencore dhe akademike. Në nivelin e UP-se ekzistojnë edhe rregulloret për avancimin e stafit akademik [A20 dhe A21]. Janë doktoruar tre nga stafi i pedagogëve – asistenteve, si dhe avancime akademike.

Personeli akademik i FN-se kanë realizuar progres të theksuar në këtë drejtim gjatë periudhës së akreditimit (2017-2020). Padyshim viti 2020, efekti i paraqitjes së fenomenit natyror – infektimi me Covid-19 ka dëmtuar edhe fushat e shkencës në shumë nga fushat në rangët Botërore dhe ka reflektuar edhe në vendin tonë dhe në Institucionin tonë. FN-ja si njësi e UP-së dhe personeli akademik i rregullt mund të përfitojnë mbështetje financiare duke u mbështetur në rregulloren për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore [A38]

2. *Fusha e burimeve, rritja e kapaciteteve, infrastruktura, vazhdimi i rindërtimit të FN-së, rritja e kapaciteteve të Bibliotekës me tekste, libra, libraritë elektronike etj.*

Gjatë periudhës 2017 deri sot janë bërë shumë investime në rregullimin e ambienteve të Fakultetit dhe krijimit të mundësisë së organizimit të mësimit cilësor. Rregullimi i ambienteve të objektit për hapësirat e Fakultetit përkatësisht të pjesës së Gjeodezisë dhe Inxhinierisë së Ambientit (hapësirat e Laboratorëve), me një investim të konsiderueshëm. Gjithashtu vlejnë të përmendet investimi në Laboratorët e Gjeomekanikës, Materialeve, Hidroteknikës, Gjeodezisë dhe Inxhinierisë së Ambientit [A41, A42, A43, A44]. Janë investime kapitale të cilat përmirësojnë cilësinë e mësimit dhe mësimit nxënien në mënyrë shumë të mirë. Tri njësitë akademike të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademike brenda

objektit të “Teknikut” për tre vitet e ardhshme kanë të planifikuara buxhetet për realizimin e rritjes së kapaciteteve të objektit, përkatësisht bibliotekës së fakultetit, rritjes së hapësirave për mësim si dhe mundësinë e zhvillimit të jetës sociale të studentëve [A49].

FN-ja permanent insiston në rritjen e numrit të librave, broshurave si dhe pasurimit të Bibliotekës së Fakultetit. Janë projekte të cilat parashihen në projekt buxhetin e viteve 2021-2023. Gjithashtu FN planifikon që të bëjë fushatë sensibilizuese te donatorët potencial në mënyrë që të rritë mundësinë e qasjes së studentëve në e-libraritë me pasuri nga fondi i shkencave teknike.

Në programet e studimeve për MSc Konstruktiv, bartësit e lëndëve janë 100% staf i përhershëm me kontratë të rregullt, ndërsa në programin e MSc Hidroteknikës nga 7 profesor bartës të lëndëve 6 janë të rregullt ndërsa një është i jashtëm (tabelat e shpërndarjes së lëndëve për programe të veçanta).

3. *Fusha për studentet, numri i vogël i diplomimit të studentëve në departamentin e Hidroteknikës i cili duhet të rritet për të plotësuar standardin.*

Studentët në Studimet e programeve të nivelit MSc, në përgjithësi janë shumë të kërkuar në tregun e punës. Kjo edhe mund të jetë arsyeja e mos diplomimit të tyre ngaqë janë të plasuar në tregun e punës. Në shërbimet e studentëve janë në evidencë studentët të cilët kanë zyrtarizuar projektet për temat e diplomave [sipas evidencës janë 120 studente] dhe janë në pritje deri në diplomimin e tyre. Procedurat administrative -për diplomimin e tyre janë të thjeshtuara edhe me rregulloren në nivel të UP-së [A8 dhe A10].

Me kurrikulën e re, janë përfshirë lëndë që promovojnë aplikimin e softwarëve sikur:

Aplikimi i GIS-it në menaxhim të ujërave, prej zgjedhore tani është lëndë obligative,  
Dinamika e ujërave nëntokësore tani është lëndë e re,  
Modelimet hidraulike po ashtu tani është lëndë e re.

4. *Financat, e pa mjaftuara për njësinë akademike.*

Korniza e Projekt buxhetit financiar për vitin 2021 -2023 [A55] është e miratuar nga Senati i Universitetit dhe Këshilli Drejtues i UP-së. FN-ja ka bërë kërkesë për rritjen e buxhetit për investime kapitale në mënyrë që të rriten hapësirat e njësive sonë akademike si dhe të niveli i tyre i cilësisë [A50]. FN-ja ka shumë projekte me të cilat do të përmirësohej dukshëm mësimdhënia dhe mësimnënia.

5. *Hulumtimet dhe ndërkombëtarizimi institucional të FN*

Institucioni akademik insiston në rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Marrë parasysh efektet globale të pandemisë veprimet e FN janë zbehur në vitin e fundit. Aktualisht janë disa marrëveshje që FN-ja ka me institucionet vendore dhe ndërkombëtare gjithashtu janë edhe marrëveshjet e UP-së të cilat ndihmojnë njësitë akademike për ndërkombëtarizimin e tyre. Misioni i FN-së është që ILA të hapet sa më shumë me bashkëpunimet ndërkombëtare dhe rajonale. Iniciativat nuk mungojnë dhe pritet që bashkëpunimet në vitin e ardhshëm të rriten (potencialisht bashkëpunimi me RUHR Bohum Unirersity, Rosse School Padova, etj.)

## 4. VLERËSIMI INSTITUCIONAL I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

### 4.1. Programi i Studimit Hidroteknike Master Shkencor MSc

<b>Emri i institucionit</b>	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
<b>Fakulteti/Departamenti</b>	Fakulteti i Ndërtimtarisë
<b>Kampusi kryesor dhe/apo Dega:</b>	Kampusi kryesor
<b>Nëse aplikohet për degë ju lutem specifikoni Degën:</b>	
<b>Emri i programit të studimit:</b>	Hidroteknike
<b>Personi Përgjegjës për programin e studimit</b>	Prof.Asoc.Dr. Laura KUSARI
<b>Akreditim/Riakreditim</b>	Riakreditim
<b>Niveli i kualifikimit sipas KKK:</b>	Niveli VII
<b>Grada akademike apo emërtimi i gradës akademike në diplomë:</b>	MSc i Ndërtimtarisë Programi Studimor Hidroteknike
<b>ECTS:</b>	120
<b>Profili i programit të studimit:</b>	Hidroteknike
<b>Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):</b>	06.04 (Ndërtimtari)
<b>Forma e Studimeve:</b>	Studime te rregullta
<b>Kohëzgjatja minimale e Studimeve</b>	2 vite
<b>Numri i vendeve për studim:</b>	20
<b>Shëno stafin e përhershëm shkencor për Programin e Studimit (Se paku 3 PhD)</b>	1. Prof.Asoc.Dr. Laura Kusari 2. Prof.Asoc.Dr. Naim Hasani 3. Prof.asoc.Dr.Figene Ahmedi

#### 4.1.1. Misioni, objektivat dhe administrimi

Misioni i Fakultetit të Ndërtimtarisë është në përputhje të plotë me misionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe mëton të zhvillojë arsim akademik, kërkime shkencore, këshillime profesionale etj. Ndërkaq, misioni i programit të studimit Hidroteknikë përputhet me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Programi i studimit në Hidroteknikë, niveli Master i studimeve ka mision të krijojë kuadro profesionale për tregun e punës, duke ofruar mësimdhënie cilësore dhe kërkime të vazhdueshme shkencore. Objektiva kryesore programit studimor është të arrihen kompetencat dhe aftësitë akademike të të diplomuarve në fushën e hidroteknikës. Kështu, do të edukohen ekspertë me njohuri të përgjithshme dhe komplekse për projektimin, ndërtimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e strukturave të ndryshme në fushën e Hidroteknikës. Studentët do të mësojnë principet moderne dhe të arriturat e fundit në sfera të ndryshme të shkencës së Hidroteknikës.

Si rezultat i veprimtarisë së Programit studimor Hidroteknikë do të arrihet të krijohen kuadro të përgaditura profesionale dhe në përputhje me kërkesat e tregut. Duke punuar në grupe, duke zgjidhur probleme të ndryshme, duke u përfshirë në punë projektuese dhe vizita në terren studentët do të fitojnë njohuri të punës ekipore dhe prezentimeve të rezultateve në publik. Programi ka për qëllim të krijojë kushte të edukimit me studentin në qendër, që ky të jetë i hapur ndaj ideve dhe mundësive të reja dhe të jetë i gatshëm të angazhohet për mësim tërëjetësor, pa kufizime. Qëllimi i programit studimor Hidroteknikë është në përputhje me qëllimin e Fakultetit të Ndërtimtarisë, që të këtë rol udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës

dhe ekonomisë, duke u mbështetur në standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimeve shkencore.

Programi studimor Hidroteknikë, krahas lëndëve shkencore bazike është në vazhdimësi i përditësuar me lëndë të reja që bazohen në kërkesat e tregut lokal dhe global, në fushat që janë gjithnjë e më të kërkuara. Programi i studimit në këtë nivel ka për qëllim që të krijojë premisa të duhura për vazhdimin e studimeve në nivele më të larta.

Programi i studimit Hidroteknikë, niveli Master është në pajtim me Kornizën e Kualifikimeve në Fushën Evropiane të Arsimit të lartë. Sipas Kornizës së kualifikimeve Kombëtare të Arsimit, ky program është i Nivelit të 7-të. Programi i studimit Hidroteknikë, niveli master ofrohet për studentët që kanë përfunduar nivelin Bachelor të studimeve, në Departamentin e Hidroteknikës. Studimet në këtë nivel zgjasin dy vite, gjegjësisht katër semestra.

1 vit akademik ka;	30 javë mësimi
1 semestër ka	15 javë mësimi
1 ECTS ka	25 orë mësimore dhe punë të studentit
1 orë mësimore ka	45' minuta

Secili semestër përmban 30 ECTS dhe përfundimisht tërë studimet, përfshirë këtu edhe punimin e temës së Diplomës, sigurojnë 120 ECTS. Përfundimi i studimeve të nivelit Master mundëson fitimin e titullit profesional Master i shkencave teknike të Ndërtimtarisë-Departamenti Hidroteknikë.

Prioritet i FN-së është siguri i cilësisë së lartë të ofertës akademike. Poashtu, kujdesi për të gjitha kërkesat e studentëve, për mbarëvajtjen, përmirësimin dhe përditësimin e ofertës akademike për studentë. Rregulloret mbi të cilat mbështet punën Fakulteti i Ndërtimtarisë janë:

Statuti i UP-së, [A1]

Udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Prishtinës, [A34]

Rregullorja për studime themelore BSc për Fakultetin e Ndërtimtarisë, [A7, A9]

Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës për administratën e Fakultetit të Ndërtimtarisë,

Rregullorja e UP-se për studime MSc në Fakultetin e Ndërtimtarisë, [A8, A10]

Ndërkaq si akte normative mbështetëse janë:

- Udhëzimi Administrativ-parimet e njohjes së gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës
- Udhëzimi Administrativ – Aplikimi i pagesave të studentëve në Universitetin e Prishtinës
- Udhëzimi Administrativ- Implementimi i ECTS në Arsimin e Lartë në Kosovë.

Secili nga dokumentet e sipër cekura janë publike dhe të qasshme në platformën digjitale të Universitetit dhe të Fakultetit si dhe në evidencat e bashkangjitura këtij raporti.

Gjatë studimeve të Hidroteknikës, niveli Master studentët pos fitimit të njohurive teorike mbi hidraulikën e ujërrjedhave të hapura dhe të ujërave nëntokësore, poashtu do të mësojnë principet moderne të shkencës së Hidroteknikës si dhe të arriturat e fundit në këtë fushë.



Poashtu studentët do të fitojnë njohuri rreth menaxhimit të projekteve në fushën e Hidroteknikës dhe posaqërisht projektimin e konstruksioneve specifike hidroteknike. Objektivat e programit studimor Hidroteknikë, niveli Master janë si në vijim:

- Të përgadisë studentët me njohuri të gjëra në fushën e Inxhinierisë Hidroteknike;
- Të njohë studentët me rolin dhe rëndësinë e menaxhimit të ujërave në shoqërinë moderne;
- Të aftësoj studentët që të marrin pjesë në planifikimin, organizimin, menaxhimin dhe implementimin e strukturave inxhinierike në fushën e Hidroteknikës;
- Të aftësoj studentët që në mënyrë të pavarur dhe kreative të bëjnë integrimin e diturive dhe shkathtësive të fituara inxhinierike për të identifikuar problemet dhe sfidat në fushën e Hidroteknikës;
- Për tregun vendor dhe më gjerë të sigurojë profesionistë të aftë të koordinojnë punën në mes të investitorëve, projektuesve dhe kontraktorëve;
- Të krijoj ekipe të profesionistëve të Hidroteknikës të aftë për të bashkëpunuar, për të krijuar dhe për të ofruar zgjedhje inovative për sfidat e menaxhimit kompleks të resurseve ujore;
- Të zhvillohet mendimi kritik i studentëve për mundësinë e vazhdimin të studimeve në nivelin e ardhshëm akademik (p.sh. studime të Doktoratës)

Për arritjen e këtyre objektivave, programi studimor Hidroteknikë ka të angazhuar personel mësimdhënës të kualifikuar, të cilët janë të ndihmuar nga profesionistë të angazhuar në strukturat menaxhuese dhe ato të administratës. Në shërbim të studentëve dhe mësimdhënësve është stafi menaxhues me Dekanin e Fakultetit të Ndërtimtarisë si përgjegjës kryesor, pastaj Prodekanin për çështje mësimore dhe Prodekanin për financa. Secili Departament në kuadër të Fakultetit ka Udhëheqësin e Departamentit i cili është përgjegjës për programet e studimeve. Secili program i studimit ka koordinatoren e programit i cili ka për detyrë hartimin e raporteve të vetëvlerësimit.

Si organ më i lartë në kuadër të Fakultetit të Ndërtimtarisë është këshilli shkencor i Fakultetit, të cilin e udhëheqë Dekani [A6]. Poashtu, funksionjnë edhe komisionet e shumta sic janë: Komisioni për mësim, Komisioni Disciplinor dhe komisione tjera të udhëhequra nga stafi akademik i Fakultetit [A28].

Rëndësi të vecantë ka edhe funksionimi i administratës së fakultetit nën menaxhimin e Sekretarit. Në shërbim të studentëve është edhe shërbimi i teknologjisë informative, shërbimi studentor dhe shërbimi teknik në laboratore. Në shërbim janë edhe personeli përgjegjës për sigurinë fizike dhe mirëmbajtjen e hapësirave të Fakultetit të Ndërtimtarisë.

### **Analiza SWOT për misionin, objektivat dhe administratën:**

#### **A. Pikat e forta:**

- Misioni është në harmoni me misionin e FN-së për përgaditje të kuadrit profesional;
- Objektivat e programit janë në përputhje me misionin dhe objektivat e fakultetit dhe janë të bazuara në kërkesat specifike të programit;

- Është në harmoni me programet për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e Hidroteknikës;
- Ofron program studimor të bazuar në kërkesat e tregut dhe kurrikulë të dizajnuar me lëndë që janë në interesin primar të studentëve;
- Ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve njerëzore që do të kontribuojnë në menaxhimin e resurseve ujore në vendin tonë;
- Synon në krijimin e profesionistëve kompetent, që mund të jenë konkurrent në tregun global;
- Administrata mundëson shërbime cilësore për mbarëvajtjen e programit të studimeve.

**B. Dobësitë:**

- Nuk vërehet ndonjë dobësi për misionin, vizionin dhe qëllimet e IAL-së.

**C. Mundësitë:**

- Zgjerimi i stafit të administratës për studentë;
- Lehtësimi i ngarkesës së administratës përmes ofrimit të shërbimeve on-line.

**D. Sfidat:**

- Krijimi i bërthamës menaxhuese/administrative për hartimin e projekteve kërkimore shkencore dhe profesionale në nivelin lokal, rajonal dhe global në fushën e hidroteknikës;
- Krijimi dhe sigurimi i fondeve për hulumtime dhe përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës ekzistuese në objekt si dhe për ngritjen e kapaciteteve teknologjike;
- Krijimi dhe sigurimi i fondeve për plotësimin e inventarit të bibliotekës dhe për paisje laboratorike;
- Konkurse në vazhdimësi për pranimin e stafit të ri akademik, që mund të angazhohet në procesin e mësimdhënies.

#### 4.1.2. Menaxhimi i cilësisë

Menaxhmenti i përbërë nga Dekani dhe prodekanët, menaxhojnë me Fakultetin e Ndërtimtarisë përmes departamenteve dhe me ndihmën e administratës. Organet kolegjiale të Fakultetit janë këshilli i FN-së i cili përbëhet prej pjesës dërmuese të stafit akademik, administratës dhe studentëve. Në Këshillin e Fakultetit diskutohen, organizohen dhe merren vendimet për çështje të ndryshme akademike/mësimore, administrative dhe studentore. Këshilli i njësisë akademike përbëhet nga stafi akademik i rregullt (profesor dhe asistent), administrata dhe dy studentë. Këshilli i FN-së merr vendimin për formimin e komisioneve për organizimin e pranimit të studentëve të ri, përkatësisht emërton koordinatorin e IAL-së për zhvillimin e programeve studimore, hartimin e raporteve për vetëvlerësim brendshëm të programeve mësimore të Fakultetit [A11, A12, A13, A14]. Koordinatorin e FN për zhvillimin e kurrikulave përkatësisht programeve të studimeve komunikon në vija të rregullta me menaxhmentin e IAL si dhe zyrën për zhvillimet Akademike në nivel të Universitetit, bartësit e programeve, stafin akademik dhe përgjegjësit tjerë lidhur me programet e studimeve [A15]. Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm RVB-ja bëhet publik në nivele kolegjiale të IAL para se të finalizohet, dhe mbështet nga stafi menaxherial i Fakultetit.

RVB-ja për programet e studimeve realizohet nga angazhimi i bartësit të programit deri te stafi akademik për periudhën e akredituar të programit si dhe brenda vitit akademik. Zakonisht në fillimin e vitit akademik secili nga stafi akademik mundet të parashtroj kërkesë më shkrim te prodekani i FN-së për mësim lidhur me nevojat e ndryshimeve eventuale të cilat për tërë programin e studimit duhet të jenë në nivelet <20%. Zakonisht ndryshimet janë të vogla, në përmbajtje të syllabuseve. Ndërsa në disa raste kur është paraqitur nevoja e ndërrimit të semestrit për ndonjë nga lëndët mësimore ajo është realizuar në nivel të këshillit të Fakultetit.

Universiteti i Prishtinës ka të hartuar planin strategjik 2020-2022 <https://www.uni-pr.edu/inc/doc/PLANI-STRATEGJIK1.pdf> [A3], për hartimin e standardit të cilësisë për arsimin e lartë në Evropën Jugore. Në këtë dokument janë të saktësuara "tetë fushat Strategjike" të cilat përmbajnë:

- Mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi,
- Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë,
- Niveli/programet e kërkuara nga tregu,
- Zhvillimi i burimeve njerëzore,
- Zhvillimi i sistemit informativ,
- Llogaria fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar,
- Zhvillimi i infrastrukturës,
- Globalizimi / Ndërkombëtarizimi,

Edhe njësitë akademike, përkatësisht Fakultetet kanë objektivat e përbashkëta me nivelin qendrorë, arritjen e standardeve në shtyllat e njëjta të përcaktuara nga niveli qendror i Universitetit.

Për të siguruar cilësinë e programit, FN-ja mbështet punën në rregulloret e miratuara në nivel të Universitetit dhe në nivel të Fakultetit si dhe në aktet normative mbështetëse. Fakulteti i Ndërtimtarisë aplikon procedurat e mësimdhënies të rregulluara sipas Rregullores për studime

bachelor (BSc) [A7, A9] dhe Rregullores për studime Master (MSc) [A8, A10], të miratua nga UNiversiteti i Prishtines dhe zbatohen në Fakultetin e Ndërtimtarisë. Në këtë mënyrë, mësimi realizohet në formë të ligjëratave, ushtrimeve numerike dhe ushtrimeve laboratorike, seminareve, punëve eksperimentale, punëve praktike në terren, vizitave studimore, konsultimeve profesionale dhe përmes punimeve shkencore.

Sipas rregullores për përcaktimin e suksesit akademik aplikohen disa mënyra të vlerësimit të dijës së fituar dhe rezultateve të pritshme të nxënies në lëndët përkatëse. Vlerësimi bëhet përmes provimeve, kolokfiumeve, punimeve seminarike, praktikës profesionale si dhe testeve praktike gjatë ushtrimeve.

Mekanizmat e cilësisë në nivel të Universitetit; me qëllim të kontrollimit të cilësisë së aktiviteteve akademike dhe atyre administrative, Senati i UP-së ka aprovuar tri lloje të instrumenteve të evaluimit të cilësisë: pyetësorët për staf akademik, pyetësorët për staf administrativ dhe pyetësorët për studentë [A52].

Krahas këtyre pyetësorëve për cilësi, në përputhje me Statutin e UP-së, vlerësimi i studentëve për mësimdhënien dhe mësimnxënien për lëndë të veçanta organizohet në baza semestrare nëpërmjet pyetësorëve anonimë për ligjëratat dhe kjo koordinohet nga dekanët e fakulteteve (ose prodekanët për mësim) në bashkëpunim me shefat e departamenteve me inicimin e prorektorit për zhvillim të cilësisë. Gjithashtu vlerësimi nga studentët për mësimdhënien bëhet edhe në platformën SEMS [A52].

Ndërkaq, sa i përket përcaktimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si mënyra të vlerësimit të dijës, aplikohen: provime, kolokfiume, punime seminarike, përfshirë edhe interpretimin dhe prezentimin e tyre, praktika profesionale si dhe teste praktike gjatë ushtrimeve. Fillimisht, vlerësimi i studentit në lëndën individuale referon nivelin e bartjes së suksesshme të njohurive të dëshiruara. Në nivel më të përgjithshëm, matjet, si p.sh. përqindja e pjesëmarrjes dhe përqindja e kalueshmërisë së studentëve në provime, po ashtu reflektojnë nivelin e arritjes së objektivave të programit.

Raporti mësimdhënës-student është i kënaqshëm, ku mësimdhënësit janë në disponueshmëri për kohë të mjaftueshme për t'u ofruar studentëve këshilla, atëherë kur ata kanë nevojë, lidhur me lëndët e caktuara. Mësimdhënësi ua ofron studentëve tekstin, literaturën bazë mësimore, udhëzimet për punime seminarike, si edhe për format e tjera të shfrytëzuara për mësimdhënie dhe mësimnxënie në kuadër të lëndës, të cilën e zhvillon. Literaturë tjetër, ofrohet si literaturë shtesë nga mësimdhënësi për studentët, të cilët shprehin interesim për studim më të hollësishëm gjatë studimeve në fushën me interes, apo për mësim gjatë gjithë jetës (life-long learning).

Vlerësimi i cilësisë së programit në kuadër të FN-së, bëhet përmes Instrumenteve për vlerësim të brendshëm dhe sigurim të cilësisë. Për këtë qëllim shfrytëzohen pyetësorët për vlerësim të lëndëve [A52]. Pyetësorët për vlerësim të lëndës realizohen në mënyrë anonime përmes Sistemit elektronik të menaxhimit të studentëve (SEMS) në koordinim me Zyrën për Zhvillim Akademik. Vlerësimi i stafit akademik gjatë realizimit të marrëdhënies së punës në Institucionin e Arsimit të Lartë bëhet edhe përmes Rregullores për procedurat përzgjedhëse

lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” të miratuar më 01/10/2019 nga Senati i Universitetit të Prishtinës.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë janë edhe përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin dhe përshtatjen e kurrikulave. Kjo bëhet konform kërkesave të të gjitha grupeve të involvuara, duke filluar nga studentët aktualë, studentët alumni dhe përgjegjësit e programeve të studimit, në koordinim me Trupin Këshilldhënës. Trupi Këshilldhënës funksionon në kuadër të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i përbërë nga stafi i fakultetit si dhe nga përfaqësues të kompanive që operojnë në tregun e Kosovës [A29]. Puna në përmirësim dhe përshtatje të kurrikulave bazohet edhe në rekomandimet e ekspertëve të jashtëm për vlerësim të programit, gjatë proceseve të vazhdueshme të riakreditimit.

Hartimi i raportit të vlerësimit të brendshëm për riakreditimin e programit të studimit për MSc Hidroteknikë është i bazuar në raportet e cilësisë për periudhat kaluese nga koha e akreditimit paraprak të programit ku për subjekt ka: emërtimi i lëndëve, bartësit e lëndëve dhe statusi i tyre.

Emërtimet e lëndëve në këtë raport janë realizuar duke u mbështetur në nocionet dhe kuptimet e programeve të studimeve në rajon dhe në Evropë.

Në Tabela 4.2.1, vijuese janë treguar arritshmëritë e studentëve, të diplomuarit në programin e studimit MSc Hidroteknikë për vitet e kaluara (nga akreditimi i fundit i programit deri në kohën e përgatitjes të këtij Raporti të vetëvlerësimit)

*Tabela 4.2.1. Numri i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar gjate tri viteve të fundit, për Departamentin e Hidroteknikës.*

Programi i studimit MSc Hidroteknikë, sipas viteve	Studentë	Të diplomuar
01/10/2017 - 30/09/2018	18	3
01/10/2018 - 30/09/2019	28	2
01/10/2019 - 30/09/2020	14	8

Është me rëndësi të theksohet se në administratën e FN-së, projektpropozime të temave të niveleve të studimeve MSc janë 120 të miratuara në Këshillin e Fakultetit, dhe janë në procedurë të diplomimit.

Bazamenti i studimeve në FN gjinden në fushat e shkencave teknike, për herën e parë programet e studimeve lidheshin me shkollën. Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë ka filluar veprimtarinë e vet me, 20 tetor 1961. Kjo shkollë kishte tri drejtime: Ndërtimtarinë, Elektroteknikën dhe Makinerinë. Që nga kjo kohë numërohet historia e programit të studimeve të Ndërtimtarisë, përkatësisht të drejtimit Konstruktiv. Kohë pas kohe programi i studimeve konstruktiv është zhvilluar dhe duke krahasuar kurrikulën e fundit të akredituar me ato paraprake ndryshimet janë të konsiderueshme në shumë drejtime.

Në Tabela 4.2.2, në vazhdim janë të pasqyruara periudhat e akreditimit të programeve të ndryshme të FN-së.

Tabela 4.2.1. Rezultatet e diplomimit te studenteve ne vitet akademike.

Programet Studimore	Akreditimi I	Ri-akreditimi II	Ri-akreditimi III	Ri-akreditimi IV
Konstruktiv (BSc)	2009 - 2011	2012 - 2015	2016 - 2019	2019-2020*
Hidroteknikë (BSc)	2009 - 2011	2012 - 2015	2016 - 2019	2019-2020*
Gjeodezi (BSc)	2009 - 2011	2012 - 2015	2016 - 2019	2019-2020*
Inxhinieri e Ambientit (BSc)	2015 - 2018	2019-2022		
Konstruktiv (MSc)	2009 - 2011	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020
Hidroteknikë (MSc)	2009 - 2011	2012 - 2013	2014 - 2017	2017-2020
Gjeodezi (MSc)	2015 - 2018	2019-2022		
Infrastruktura Rrugore (MSc)	2012 - 2013	2014 - 2017		

Ne tabelën 4.2.2, \*shenja i referohet vazhdimit te akreditimit sipas vendimit [A39]

Edhe ky raport i vetëvlerësimit të brendshëm merr parasysh efektet e nevojave të ndryshimeve dhe përditësimin e elementeve më thelbësore të programit, sikur janë metodat didaktike të mësimdhënies (duke marrë parasysh certifikimin e stafit akademik në nivel të Universitetit), syllabuset e freskuara, ngarkesa e studentit, sistemi i cilësisë etj.

Ngarkesa nga obligimet e studentëve për programin e studimit MSc Hidroteknikë është e vlerësuar dhe aplikohet në bazë të 120 ECTS kredive përfundimtare që merr studenti pas përfundimit të studimeve. Arritja e kompetencave të studentit brenda dy viteve të studimit është e përcaktuar mirë dhe ka një shtrirje vit pas viti shumë të studiuar.

Pas përfundimit të studimeve, një pjesë e konsiderueshme e studentëve të diplomuar gjejnë plasmanin në tregun e punës (në sektorin privat si; studio projektimi, punishte ndërtimi, reparte prodhimi etj, ose në institucione publike, komunat, ndërmarrjet publike, Ministrinë etj.), një pjesë e tyre vazhdojnë studimet në programet e doktoratës në universitet jashtë vendit.

#### **Analiza SWOT për menaxhimin e cilësisë:**

##### **A. Pikat e forta:**

- Menaxhimi dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies dhe monitorimi i mësimdhënies.
- Monitorimi i cilësisë dhe i sigurisë së shërbimeve te studenti.
- Shërbime të shpejta, të garantuara dhe cilësore për mësimdhënësin dhe Studentin.
- Transparenca e arritshmërisë në nivel të njësisë akademike.
- Shërbimet e administratës për nevojat e njësisë akademike të kënaqshme.

##### **B. Dobësitë:**

- Nuk vërehet ndonjë dobësi për menaxhimin e cilësisë ne nivel të IAL-së.

##### **C. Mundësitë:**

- Bashkëpunimi me biznesin, tregtinë, industrinë, komunitetin punëdhënës për t'u mundësuar mësimdhënësve ngritjen e cilësisë së kurrikulës në kontekst të nevojave të tregut të punës.

##### **D. Sfidat:**

- Sigurimi i kuadrit të nevojshëm deri në kohën e rekrutimit;

- Plotësimi i vendeve të reja të punës për mësimdhënës, asistentë dhe/ose shërbim administrativ që ndihmon në kërkesën për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.

#### **4.1.3. Staf i akademik**

Stafi akademik dhe drejtuesit akademik kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Ndërtimtarisë, konsulta për studentët, dhënie e ndihmës për studentët si dhe detyrat administrative në funksion të mësimdhënies.

Për sa i përket procedurës së lidhjes së kontratës së punës, çdo anëtar i stafit administrativ dhe stafit akademik ndjek një procedurë të tillë e cila është rregulluar me statusin e UP-së [A1] si dhe rregulloreve në nivel Institucional [A20, A21, A22]. Njësia akademike, përkatësisht Fakulteti parashtron kërkesën në Senatin e UP-së për nevojat e stafit akademik dhe administrativ para fillimit të vitit akademik. Pas miratimit të kërkesës nga Senati, zhvillohen procedurat në pajtim me Statusin e UP-së [A1] dhe rregulloreve [A20, A21, A22] deri në finalizimin e kontratës [A32, A33, A34]. Konkurset për personel akademik të rregullt pune, përkatësisht konkurset për avancime akademike organizohen deri në nivel të UP-së, përkatësisht Senatit. Procedurat janë të përshkruara në Rregulloren mbi emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2019 [A20]. Sipas rregulloreve njësia akademike realizon raportet e vlerësimeve në bazë të meritokracisë dhe standardeve të caktuara sipas statutit të UP-së [A1], të njëjtat i miraton këshilli i njësisë akademike dhe procedohen për më tutje deri në miratimin përfundimtar të tyre nga Senati i UP-së. Pas miratimit nënshkruhet kontrata e punës [A31]. Personeli i angazhuar kategorizohet në, personeli brenda njësive akademike të UP-së dhe personeli i angazhuar sipas konkursit për angazhim. Në procedurat administrative të UP-së kategoritë e personelit akademik dallohen sipas formularëve të angazhimit, sikur:

Formulari F1, personeli akademik i rregullt

Formulari F2, personeli akademik brenda UP-së dhe

Formulari F3, personeli akademik i angazhuar (me konkurs).

Për kategorinë e personelit akademik të angazhuar (F3), lëshohet kontratë pune periodike në varësi të nevojës së programit të studimit përkatësisht Institucionit. Këto kontrata kanë kohëzgjatje deri një vit akademik. [A32]. Në këtë kategori hynë stafi akademik i pensionuar (mosha nga 65 deri në 70 vjet).

Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimdhënës, administrativ e mbështetës të lëndëve të ofruara në FN, specifikisht në programin e studimit MSc Konstruktiv, FN synon të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të garantoj cilësi shumë të lartë mësimdhënëse dhe kërkuese/hulumtuuese shkencore. Staf i akademik mbetet faktori kryesor në garantimin e cilësisë në mësimdhënie dhe transferimin e dijeve tek studentët.

Për përmbushjen e këtij objekti madhor, stafi i angazhuar në programin MSc Hidroteknikë, është në mënyrë të vazhdueshme i përditësuar për të rejtat më të fundit në fushën e hidroteknikës.

Universiteti i Prishtinës ka themeluar Qendrën për përsosmëri në mësimdhënie (QPM) me qëllim të ofrimit të shërbimeve për aftësimin, brumosjen kualitative dhe të fisnikërimit

profesional të kuadrit Universitar në sferën e mësimdhënies dhe të nxënies. Duke u mbështetur në të dhënat zyrtare <https://uni-pr.edu/page.aspx?id=2,78> brenda një periudhe kohore të shkurtër të vitit 2019 mbi 70 mësimdhënës e bashkëpunëtor të UP-së u certifikuan për mësimdhënie të reformuar e bashkëkohore në Universitet. Pjesa më e madhe e stafit akademik të programit të studimit për MSc Konstruktiv janë certifikuar nga QPM e UP-së <https://www.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,4,566>. Këto trajnime kanë reflektuar shumë pozitivisht edhe në përmirësimin e këtij raporti duke pas parasysh përpilimin e syllabusave në mënyrë shumë të saktë dhe përmbajtësor, metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, etj.

Objektivi kryesor i programit të studimit MSc Hidroteknikë është që të përgatisë studentët profesionalisht si Inxhinierë Ndërtimi në profilet e Hidroteknikës me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik.

Programi i studimit MSc Hidroteknikë, numëron gjithsej 15 mësimdhënës (8 profesorë dhe 7 asistentë). Sipas titujve akademik, në program ligjërojnë: tre Profesorë të Asocuar (Prof. Asoc. Dr.); katër Profesorë asistentë (Prof. Ass. Dr.); një ligjërues i angazhuar [A47].

Punimi i diplomës nuk ka bartës dhe kjo është e drejtë e studenteve që të përcaktojnë fushën e studimeve përkatësisht paraprojektin e diplomës me njërin nga mësimdhënësit nga programi i studimit. Problem në vete mbetet çështja e ngarkesës së mësimdhënësit për punimin e diplomës dhe punën praktike e cila nuk llogaritet si ngarkesë te stafi akademik. Për hartimin e diplomës MSc studenti merr 30 ECTS dhe në nivel të UP-së ekziston rregullorja e studimeve Master e cila specifikon procedurat e punimit të diplomës. FN-ja ka të krijuar formën dhe procedurat [A8, A10] me formularët [A51] të cilët janë pjesë e procedurave për realizimin e temës së diplomës.

Vlerësimi i mësimdhënësit, lëndës, mësimdhënies, metodikës së mësimdhënies, literaturës etj. bëhet nga studentët në mënyrë të pavarur dhe të pacenzuruar në variantin elektronik në platformën e SEMS. Janë të krijuara datotekat e shënimeve me vlerësime të pedagogëve [A52], pastaj vlerësohet edhe administrata. Vlerësimet janë me mundësi të qasjes nga Rektorati i UP-së dhe periodikisht këto raporte i dorëzohen Dekanit të njësisë akademike.

Si strategji të rëndomta për përmirësimin, përkatësisht implementimin e masave për sigurimin e cilësisë mund të konsiderohen:

- përditësimi i syllabuseve, me ç ‘rast në mënyrë të hollësishme paraqiten njësitë mësimore, qëllimi i kursit, rezultatet e pritura të nxënies, metodat e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, rregullat e mirësjelljes si dhe literatura bazë dhe ajo shtesë.
- njoftimi i studentëve me syllabuse dhe programe të shkurta nga ana e secilit mësimdhënës në orën e parë të kursit.
- Syllabuset e lëndëve janë publike në faqen elektronike të fakultetit [https://fna.uni-pr.edu/Shpallje-dhe-rezultate-\(1\)/Master/Syllabuset/Konstruktiv.aspx](https://fna.uni-pr.edu/Shpallje-dhe-rezultate-(1)/Master/Syllabuset/Konstruktiv.aspx)
- hartimi i programeve të shkurtra për të gjitha lëndët mësimore.
- përpilimi dhe dorëzimi i raporteve mbi kalueshmërinë e studentëve për çdo afat të zhvilluar të provimeve.
- Pyetësorët për gjendjen e përgjithshme të plotësuar nga stafi akademik, administrativ dhe studentët me rastin e vlerësimit institucional.
- Formulari për llogaritjen e ngarkesën e studentëve.



Me çka dhe sigurohet rritja e shkallës së transparencës së punës ndërmjet mësimeve dhe studentëve.

Sipas ligjit të punës në nivel të shtetit, pensionimi i personelit të rregullt akademik është i përcaktuar kur i punësuari mbush moshën 65 vjeç. Praktikantët e FN-së përkatësisht të UP-së, nëse njësia akademike e vlerëson të nevojshme atëherë personelin e pensionuar mund ta angazhojë me kontratë si personel të jashtëm deri në moshë 70 vjeç dhe me normë të zvogëluar (maksimum 5 orë akademike, ose dy lëndë mësimore) [A31, A32, A33].

### **Analiza SWOT për stafin akademik:**

#### **A. Pikat e forta:**

- Mësimeve profesionale të kualifikuara;
- Mësimeve me përvojë akademike dhe eksperiencë në hulumtime ndërkombëtare;
- Mësimeve të trajnuara për metoda të reja në mësimdhënie dhe për praktika të vlerësimit të studentëve në kontekst të mësimdhënies.

#### **B. Dobësitë:**

- Nuk vërehet ndonjë dobësi lidhur me stafin akademik, proceset e punësimit dhe zhvillimit profesional.

#### **C. Mundësitë:**

- Angazhimi dhe akomodimi i profesorëve nga Universitetet tjera ndërkombëtare;
- Avansimi i asistentëve aktual për ngritjen e kapaciteteve në mësimdhënie;
- Zgjerimi i tregut të punës dhe hapja e kufinjëve për të mundësuar plasman të kuadrit profesional në fushën e Hidroteknikës.

#### **D. Sfidat:**

- Avansimi i kuadrove me thirrje akademike;
- Sigurimi i mbështetjes institucionale-financiare për ngritjen akademike dhe aktivitetin kërkimor të stafit mësimeve;
- Procedura burokratike gjatë gjedhjes së personelit akademik.

#### 4.1.4. Përmbajtja e procesit arsimor

Në objektivin e Programit të Studimit MSc Hidroteknikë është definuar qasja ashtu që të garantojë formim të avancuar dhe kompetenca të specializuara përmes dhënies së njohurive teorike dhe praktike më të thelluara në fushën e Strukturave, si dhe të aftësojë studentët për kryerjen e kërkimit të pavarur shkencor përmes dhënies së njohurive, metodave dhe teknikave të kërkimit shkencor.

Organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies përbën procesin që ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarëvajtjen ashtu dhe në aspektin cilësor. Metodave dhe Teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e ciklit të parë bashkë janë të shumëllojshme. Krahas formave të mirënjohura të mësimdhënies njëdrejtimore (nga pedagogu tek studenti), këto metoda tentojnë drejt formave të mësimi me pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe strukturimin e ideve të tyre me kontributin e përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e ligjëruesit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve.

Programi i studimeve Hidroteknikë, niveli Master u dedikohet:

1. Të diplomuarve që kanë përfunduar nivelin Bachelor të studimeve në Hidroteknikë, në kohëzgjatje 3 vjeqare të studimeve dhe të cilët kanë arritur përmbushjen e 180 ECTS-ve.
2. Të diplomuarve që kanë përfunduar nivelin Bachelor të studimeve në fusha tjera të drejtimeve teknike, me kusht që gjatë procesit të regjistrimit t'iu nënshtrohen provimeve plotësuese shtesë, të cilat rregullohen e rregulloren e studimeve Master.

Numri i vendeve të lira për aplikim përcaktohet në konkursin e shpallur nga Universiteti i Prishtinës, pas propozimeve të bëra nga Departamenti përkatës në lidhje me numrin e studentëve dhe miratimit të këtij propozimi në Këshillin e Fakultetit të Ndërtimtarisë. Në konkurs janë të specifikuar edhe kriteret e pranimit gjegjësisht regjistrimit të studentëve të rinj, provimi pranues, shpallja e rezultateve preliminare, ankesat dhe shpallja e rezultateve përfundimtare. Pra e tërë dinamika e rrjedhjes së procesit është specifikuar në konkursin publik, të shpallur nga ana e Senatit të UP-së.

Programi i studimit për Master Hidroteknikë, është në përputhje me Kornizën për Kualifikime në Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë i cili saktëson se Cikli i 2-të i studimeve përmbanë (60–120) ECTS kredite - zakonisht përfundon me Shkallën Master (Masteri Profesional 60ECTS, ndërsa Masteri Shkencorë 120 ECTS).

Gjithashtu edhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të shtetit të Kosovës programi i studimeve MSc Hidroteknikë i takon nivelit të dytë të studimeve me 120 ECTS të zhvilluar në 2 vite studimi (me 4 semestra).

Shpërndarja e ECTS është 30 ECTS kredi për çdo semestër, apo 60 ECTS për një vit akademik.

Struktura vertikale e KKK-së bazohet në tetë nivele kualifikimi me referim përkundrejt tetë niveleve referente të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Secili nivel është përcaktuar me një formulim të rezultateve tipike mësimore bazuar në qasjen e adoptuar nga KEK, të përcaktuar sa i përket:

- Njohurive - të cilat mund të jenë teorike apo praktike;
- Shkathtësive - të cilat mund të jenë njohëse, kreative apo praktike;
- Kompetencave më të gjëra - veçanërisht autonomi dhe përgjegjësi.

Tetë nivelet e KKK kanë për qëllim t'i referohen tetë niveleve të KEK, e cila siguron një standard ndërkombëtar për matjen e nivelit të kompleksitetit të rezultateve të mësimin. Sipas KKK, studimet e nivelit Master Hidroteknikë i takojnë nivelit të 7-të [A35].

Strategjia e Fakultetit të Ndërtimtarisë në lidhje me programin studimor është të mundësojë edukim cilësor duke nxitur kreativitetin, pranimin e ideve të reja dhe mësimin tërëjetësor. Programi studimor Hidroteknikë është i përkushtuar në arritjen e këtyre objektivave duke ofruar kurrikulë moderne dhe fleksibile në raport me kërkesat e tregut rajonal dhe global.

Procedurat e mësimdhënies janë të rregulluara sipas Rregullores për studime Bsc dhe Msc të FN-së dhe sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Sipas nenit 16 të Rregullores për studime BA dhe MA të FN-së mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, punëve eksperimentale, punëve praktike në teren, vizitave studimore, diskutimeve profesionale, projekteve, konsultimeve profesionale dhe përmes punimeve shkencore të studentëve.

Programi i studimit i nivelit Master në Hidroteknikë përmban pjesën teorike të ligjëratave të kombinuar me pjesën praktike, e cila është e përbërë nga ushtrimet numerike, ushtrimet laboratorike, punët seminarike dhe vizitat në terren. Raporti në mes të pjesës teorike dhe praktike në këtë program studimor është 60:40.

Lëndët e programit të studimit MSc Hidroteknikë Master kanë shtrirje në fusha të ndryshme (profesionale) qëllimi i të cilave është që ato të komplementojnë njëra tjetrën. Programi i studimit MSc Hidroteknikë, përmban 22 lëndë mësimore. Nga të gjitha lëndët e programit të studimit, 15 janë lëndë obligative ndërsa 7 lëndë janë zgjedhore. Lëndët obligative kanë gjithsej 75 ECTS kredite, punimi i diplomës ka 30 ECTS dhe është e detyruar për çdo Student. Ndërsa nga lëndët zgjedhore kerkohen të sigurohen gjithsej 15 ECTS kredite. Në grupin e lëndëve zgjedhore studenti ka mundësi të zgjedhë varësisht nga preferenca e fushës së tij të studimit dhe të plotësojë numrin e ECTS krediteve ashtu që për çdo semestër të sigurohen 30 ECTS kredite. Semestri i katërt i studimeve është i paraparë për studentin që të punojë temën e diplomës Master, me ç'rast fitohen 30 ECTS dhe kur kombinohen me kreditë e lëndëve obligative dhe kreditë e fituara nga lëndët zgjedhore, përmbushet kriteri i 120 ECTS për nivelin Master të studimeve.

Programi i studimeve MSc Hidroteknikë, klasifikohet në grupe të lëndëve me karakter të formimit të përgjithshëm, formim të vecant të lëndëve shkencore dhe profesionale. Grupi i lëndëve të formimit të përgjithshëm janë: Metodologjia hulumtuese shkencore, Menaxhimi i projekteve, Menaxhimi i ndërtimit. Grupi i lëndëve specifike fundamentale në Hidroteknikë janë: Hidrologjia II, Rregullimi i lumenjëve, Inxhinieria e kullimit, Gjeoteknika e objekteve hidroteknike, Furnizimi me ujë i vendbanimeve II, Teknologjitë e trajtimit të ujit të pijes, Pendat, Kanalizimi i vendbanimeve II, Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave II, Teknologjitë e trajtimit të ujit të Ndotur, Mbrojtja e integruar nga vërshimet, Aplikimi i GIS në menaxhim të

ujërave. Grupi i lëndëve profesionale zgjedhore si: Hidrogjeologjia, Tunelet, Fondimet e vecanta, Menaxhimi i resurseve ujore, Ekonomia e ndërtimit, Dinamika e ujërave nëntokësorë, Modelimet Hidraulike.

Tabela 4.2.3. Organizimi i lendeve sipas kategorive.

Fusha/ disciplina	Veprimtaria formuese	ECTS		
		ECTS	Total	%
Lëndët e përgjithshme	Metodologjia hulumtuese shkencore	3	12	10
	Menaxhimi i projekteve	3		
	Menaxhimi i ndërtimit	6		
Lëndët e formimit shkencorë hidroteknike	Hidrologjia II	6	63	52.5
	Rregullimi i lumenjëve	6		
	Inxhinieria e kullimit	6		
	Gjeoteknika e objekteve hidroteknike	3		
	Furnizimi me ujë i vendbanimeve II	6		
	Teknologjitë e trajtimit të ujit të pijes	6		
	Pendat	6		
	Kanalizimi i vendbanimeve II	6		
	Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave II	6		
	Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur	6		
	Mbrojtja e integruar nga vërshimet	3		
	Aplikimi i GIS në menaxhim të ujërave	3		
Lëndët e formimit profesional zgjedhore	Hidrogjeologjia	3	Minimumi nga lëndë zgjedhore 15	12.5
	Tunelet	3		
	Fondimet e vecanta	3		
	Menaxhimi i resurseve ujore	3		
	Ekonomia e ndërtimit	3		
	Dinamika e ujërave nëntokësorë	3		
	Modelimet hidraulike	6		
Diploma	Punimi i Diplomës	30	30	25

Grupi i lëndëve specifike fundamentale në syllabuset e tyre kanë paraparë përveç pjesës teorike edhe pjesën praktike. Pjesa e praktikës mendohet se kryesisht realizohet përmes ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike (brenda dhe jashtë institucionit) dhe me vizita në shumë kompani industriale nga fushat specifike që lidhen me lëndët. Raporti në mes të pjesës teorike dhe praktike në këtë program studimor është 60/40.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë përgjegjës për akreditimin e fundit, “programi akademik Hidroteknikë, niveli Master i përmbush standardet europiane dhe korrespondon mirë me

praktikat ndërkombëtare. Numri dhe shpërndarja e lëndëve në mes të semestrave është adekuate, si dhe raporti në mes pjesës teorike dhe praktike është poashtu adekuat”. (Raporti Final i grupit të ekspertëve rreth procedurës së ri akreditimit të programeve Master, në Fakultetin e Ndërtimtarisë, më datën 12/06/2017.

Sa i përket vlerësimit të studentëve, dituria e fituar kontrollohet dhe vlerësohet në secilën lëndë individualisht. Procesi mësimor në cdo lëndë përfundon me vlerësimin e njohurive dhe aftësive të fituara. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të fituara anë të përshkruara në syllabusin e cdo lënde dhe mund të jenë: Vlerësimi me shkrim, vlerësimi me gojë, testet ndërsemestrare, punët seminarike, detyrat teorike, ustrimet praktike, ushtrimet laboratorike, projektet. Studenti merr një notë përfundimtare nga metodat e ndryshme të vlerësimit.

Rregullat e përgjithshme për vlerësimin e njohurive sipas Rregullores mbi studimet master janë të përcaktuara me Statut të Universitetit të Prishtinës. Kështu sipas nenit 109, Niveli i suksesit në provime në njësitet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” përshkruhet më notat si në vijim:

- 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm),
- 8 (shumë mirë),
- 7 (mirë),
- 6 (mjaftueshëm),
- 5 (pamjaftueshëm).

Studenti kalon provimin me sukses me notat (6 -10).

Sa u përket provimeve, organizohen në këto mënyra: me shkrim, me gojë, me shkrim dhe me goje dhe praktike. Mënyra e përcaktimit të dijës dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit studimor të nivelit Master është e bazuar në bashkëpunimet me Universitetet të cilat kanë të arritura dhe traditë të gjatë për këtë nivel të studimeve dhe programeve studimore. Programet studimore janë të akredituara dhe të bazuara në sistemin e Bolonjes; e në këtë rast si bazë janë marrë Universiteti i Zagrebit - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit; Universiteti i Lubjanës - Fakulteti i Ndërtimtarisë, Arkitekturës dhe Gjeodezisë; Universiteti i teknologjisë TU Delft, Holandë; Universiteti i Hanoverit në Gjermani dhe Universiteti i Shtutgartit, në Gjermani; TU Wien, Austri.

Programi i studimit Hidroteknikë i Nivelit master është 80% i krahasueshëm me Fakultetin e Ndërtimtarisë, Universiteti i Zagrebit.

Studenti përfundon studimet pas përmbushjes së të gjitha obligimeve të përshkruara, arritjes së 120 ECTS kredive, duke përfshirë këtu edhe punën praktike dhe dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit të Diplomës Master. Me këtë rast studentit merr titullin akademik: Magjistër i shkencave teknike të ndërtimtarisë - Departamenti Hidroteknikë.

Pas përfundimit të studimeve të nivelit Master Hidroteknikë, kandidati fiton rezultatet duke i zbatuar si kompetenca që:

- Lexon në mënyrë kritike, hulumton, mbledhë dhe kupton literaturën relevante shkencore në fushën e shkenave të Hidroteknikës;
- Aplikon njohuritë dhe shkathtësitë e fituara për të planifikuar, dizajnuar, ndërtuar, mbikqyrë dhe mirëmbajë objektet komplekse hidroteknike;
- Zbaton nivel të lartë të njohurive profesionale dhe aftësi të aplikimit të tyre në identifikimin, analizën dhe zgjidhjen e prolemeve në fushën e Hidroteknikës;
- Prezanton kreativitet të lartë dhe risi si rezultat i programit studimor interdisciplinar;
- Prezanton standarde të larta etike gjatë punës me klientë dhe ofron ekspertizë të qëndrueshme dhe të paanshme;
- Zbaton aftësi për të projektuar dhe për të implementuar konstruksione në fushën e Hidroteknikës, të cilat janë në përputhje me kualitetin dhe cmimet e duhura;
- Analizon dhe merr parasyshë risqet ambientale të shoqëruara me ndërtimin në fushën e Hidroteknikës;
- Menaxhon grupe të profesionistëve në planifikim, projektim dhe implementin të ndërhyrjeve të ndryshme në ambientin ujqor;
- Koordinon punën në mes të investorëve, projektuesve dhe kontraktorëve;
- Përcjellë risitë dhe aplikon ato në profesion.

*Tabela 2.2.4. Pasqyra e programit, kurikula e programit te studimeve MSc Hidroteknikë*

<b>Viti I</b>						
<b>Semestri I</b>			<b>Orët/ Java</b>			
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lënda</b>	<b>L</b>	<b>U*</b>	<b>ECTS</b>	<b>Profesori</b>
1	O	Hidrologjia II	2	2	6	Prof.asoc. dr. Naim Hasani
2	O	Rregullimi i lumenjëve	2	2	6	Prof.asoc.dr. Laura Kusari
3	O	Inxhinieria e kullimit	2	2	6	Prof.asoc.dr. Laura Kusari
4	O	Menaxhimi i projekteve	2	0	3	Prof.ass.dr. Esat Gashi
5	O	Metodologjia hulumtuese shkencore	2	1	3	Prof.ass.dr. Ragip Hadri
6	O	Gjeoteknika e objekteve hidroteknike	2	1	3	Prof.ass.dr. Qani Kadiri
7	Z	Dinamika e ujërave nëntokësorë	2	1	3	Dr.sc. Lavdim Osmani
8	Z	Hidrogjeologjia	2	1	3	Prof.asoc.dr. Naim Hasani
<b>Semestri II</b>			<b>Orët/ Java</b>			
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lënda</b>	<b>L</b>	<b>U*</b>	<b>ECTS</b>	<b>Profesori</b>
1	O	Furnizimi me ujë i venbanimeve II	2	2	6	Prof.asoc.dr. Naim Hasani
2	O	Teknologjitë e trajtimit të ujit të pijes	2	2	6	Prof.asoc.dr. Figene Ahmedi
3	O	Pendat	2	2	6	Dr.sc. Lavdim Osmani
4	O	Menaxhimi i ndërtimit	2	2	6	Prof.ass.dr. Esat Gashi
5	O	Aplikimi i GIS-it në menaxhim të ujërave	2	1	3	Prof.ass.Dr. Ymer Kuka
6	Z	Tunelet	2	1	3	Prof.ass.dr.Qani Kadiri
7	Z	Ekonomia e ndertimit	2	1	3	Prof.ass.dr. Esat Gashi
<b>Viti II</b>						
<b>Semestri III</b>			<b>Orët/ Java</b>			
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lënda</b>	<b>L</b>	<b>U*</b>	<b>ECTS</b>	<b>Profesori</b>
1	O	Kanalizimi i vendbanimeve II	2	2	6	Prof.asoc.dr. Naim Hasan

2	O	Shfrytëzimi i fuqisë së ujërave II	2	2	6	Dr.sc. Lavdim Osmani
3	O	Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur	2	2	6	Prof.asoc.dr. Figene Ahmedi
4	O	Mbrojtja e integruar nga vërshimet	2	1	3	Prof.asoc.dr. Laura Kusari
5	Z	Fondimet e vecanta	2	1	3	Prof.ass.dr. Qani Kadiri
6	Z	Menaxhimi i resurseve ujore	2	1	3	Dr.sc. Lavdim Osmani
7	Z	Modelimet hidraulike	2	2	6	Dr.sc. Lavdim Osmani
<b>Semestri IV</b>						
<b>Nr.</b>	<b>O/Z</b>	<b>Lënda</b>	<b>L</b>	<b>U*</b>	<b>ECTS</b>	<b>Profesori</b>
1	O	Punim diplome			30	

**(U\*) Ushtrime praktike apo laboratorike te cilat organizohen ne grupe sipas Statutit dhe Rregulloreve ne fuqi te UP-s (ref: Rregullore 2/486 te dates 11/09/2019, Neni 16 – pika 2, tabela Nr.7 dhe Neni 17 – pika 2, tabela Nr.10)**

Sipas statutit të UP-së, për çdo 1 ECTS kalkulohej 25-30 orë studimi. Një shembull i kalkulimeve të ngarkesës së studentit që reflekton se si i caktohen 3 dhe 6 ECTS për një lëndë shihet në tabelat në vijim.

Tabela 4.2.3. Shembull i përcaktimit të ngarkesës së studentit

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsejt
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Puna praktike	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			
Konsultimet me mësuesin	1	3	3
Puna në terren	2	1	2
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			3
Përgatitja për provim final			4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Totali</b>			<b>75</b>

### Analiza SWOT për përmbajtjen e procesit arsimor:

#### A. Pikat e forta:

- Ndërdisciplinarteti i programit studimor;
- Program akademik specifik dhe i bazuar në kërkesat e tregut,
- Program që u mundëson studentëve specializimin apo vazhdimin e studimeve edhe në vendet tjera,
- Përmbajtja e lëndëve të ndryshme dhe pjesa praktike e tyre mundëson bashkëpunim të fuqishëm me kompani vendore,

#### B. Dobësitë:

- C. Nuk vërehet ndonjë dobësi persa i përket procesit mesimor.

**D. Mundësitë:**

- Zgjerimi i kapaciteteve të laboratorëve të Hidroteknikës;
- Aplikimet e modeleve kompjuterike në kurrikulë,
- Zgjerimi i bashkëpunimit dhe angazhimit të studentëve në komunitet,
- Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve në Universitete Ndërkombëtare në fushën e Hidroteknikës.

**E. Sfidat:**

- Rivlerësimi dhe ndryshimi i kurrikulës,
- Investimet në kapacitetet e laboratorëve të Hidroteknikës.



#### 4.1.5. Studentët

Studentët janë pjesa më integrale e Universitetit tonë, përkatësisht Fakultetit të Ndërtimtarisë. Pjesë e misionit të FN-së do të jetë “Studenti në qendër të vëmendjes” dhe ata janë në fokus të të gjithë aktivitetit tone akademik, shkencor hulumtues. Ky program studimi nxjerrë brez pas brezi të diplomuar të cilët janë të plasuar në tregun e punës si brenda ashtu edhe jashtë vendit në nivel jashtëzakonisht të kënaqëshëm ndërsa një pjesë e tyre vazhdojnë edhe studimet e doktoratës në institucione jashtë vendit.

Qëllimi i Programit të Studimit MSc në Hidroteknikë është që të përgatisë studentët profesionalisht si Inxhinierë së Hidroteknikës me mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik. Ky program studimi i ciklit të parë synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në vend dhe Evropë.

Në nivel të Universitetit ekziston rregullorja e përgjithësuar e studimeve të nivelit MSc e cila ndihmon njësitë akademike për organizimin dhe studimeve të këtij niveli [A8, A10]. Në kuadër të kësaj rregulloreje janë të përcaktuara përveç tjerash kompetencat e studentëve, detyrat e tyre etj.

Menaxhimin e vijimit të rregullt të procesit mësimor dhe kryerjes së obligimeve të tjera të parapara me programin e studimeve MSc Hidroteknikë, në lëndën e caktuar nga kurrikula e programit konfirmohet në fund të semestrit në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS).

Detyrat e Studentit janë:

- Studenti duhet të ndjekë procesin mësimor (ligjërata, seminare, ushtrime në laboratorë, etj) sipas orareve dhe planeve të përcaktuara bazuar në Rregulloren e Studimeve dhe akteve të tjera në fuqi të Fakultetit. Kriteri i prezencës të paktën 75% është parakusht.
- Të njohë me hollësi rregullat e fakultetit dhe detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre.
- Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit [A1], nga Rregullorja për studime të nivelit MSc [A8, A10] dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për Arsimin e Lartë.
- Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve.
- Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të Fakultetit nga ana e tij, dëmi material që ai mund të ketë bërë.
- Të respektojë etikën e paraqitjes së jashtme në përputhje me karakterin akademik të Fakultetit përkatësisht të Universitetit.
- Të ruajë e të respektojë etikën e sjelljes me stafin akademik, stafin joakademik, stafin e shërbimit, me studentët e tjerë, në mjediset e Fakultetit, në orët e mësimin, në praktikat mësimore dhe në çdo aktivitet tjetër të organizuar nga Fakulteti përkatësisht Universiteti.
- Të ruajë e të respektojë paprekshmërinë e orës së mësimin dhe të pedagogut në mësim.

Studenti i cili arrin që të përfundon të gjitha provimet e parapara në kurrikulën e programit dhe diplomën dhe grumbullon së paku 120 ECTS merr titullin e Master i shkencave të Ndërtimtarisë, Departamenti Hidroteknikë, FN.

Punimi i diplomës në programin e studimit MSc Hidroteknikë punohet individualisht nga studentit, duke vërtetuar se aftësitë teorike respektivisht eksperimentale të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për njohjen e disa problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore të konstruksioneve. Është rregullorja e studimeve [A8, A10] e cila përcakton edhe procedurën e punimit të diplomës. Studenti duhet të deklarohet për plagjiaturën gjatë punimit të diplomës.

Ekziston procedura e pranimit të studentëve për programin e studimit MSc Hidroteknikë dhe që organizohet nga Fakulteti në mënyrë standarde duke respektuar kushtet e konkursit.

Në studimet Master për Hidroteknikë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë ata të cilët kanë përfunduar studimet themelore në programet e studimeve BSc Hidroteknikë dhe që nga këto studime posedojnë arritshmëri të 180 ECTS krediteve. Numrin e studentëve të rinj për program studimor MSc Hidroteknikë, kriteret e pranimit përkatësisht regjistrimit, dinamikën e rrjedhës së procesit, provimin pranues, shpalljen e rezultatit preliminar, ankesat dhe shpalljen e rezultatit final në mënyrë të hollësishme i përcakton konkursi publik i shpallur nga ana e Senatit të UP-së <https://uni-pr.edu/desk/inc/media/AEE5CABB-5CD7-4418-9489-03949385902A.pdf>.

Procedurat e pranimit të studentëve nisin nga niveli i Senatit të Universitetit deri te njësi akademike. Senati merr vendim për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve nëpër njësitë akademike. Numri i studentëve nëpër programe të studimit propozohet nga vet Fakulteti dhe zakonisht miratohet i njëjti në Senat (mund të ketë edhe përjashtime). Në konkurs saktësohen kërkesat minimale si dhe kriteret e vlerësimit për secilën njësi akademike përkatësisht program të studimit.

Provimi për pranimin e studentëve organizohet nga Fakulteti. Këshilli i fakultetit formon komisione për hartimin e provimeve, komisione për verifikimin e dokumentacionit, komisione për vlerësimin e provimeve. Në nivelin më të lartë të organizimeve është komisioni qendrorë për organizimin e konkursit i përbërë nga stafi menaxherial i fakultetit.

Nëse studentët e fushave tjera të drejtimeve teknike janë të interesuar për këtë nivel të studimeve universitare në programin studimor Hidroteknikë ata duhet t'u nënshtrohen provimeve plotësuese sipas rregullores së studimeve Master [A8, A10], me ndihmën e komisionit të studimeve në nivel të Fakultetit.

Studentët e nivelit Master në departamentin e Hidroteknikës do të kenë mundësi të vijojnë studimet sipas kurrikulës aktuale e cila është e vlerësuar dhe miratuar në Këshillin e Fakultetit të Ndërtimtarisë. Kurrikulat në vazhdimësi vlerësohen gjatë proceseve të vazhdueshme të ri akreditimit dhe të gjitha rekomandimet e ekspertëve analizohen dhe merren parasysh gjatë përditësimit të kurrikulave. Sic mund të shihet edhe nga përshkrimet e shkurtëra dhe syllauzet e lëndëve, shumica e lëndëve profesionale përbëhen nga pjesa teorike e ligjëratave dhe nga pjesa praktike e cila mund të organizohet në formë të ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike, seminareve, elaborateve të ndryshme dhe vizitave në terren.

Rezultatet e të nxënit, pas përfundimit të studimeve Master, studentët do të kenë mundësi të:

- Kuptojnë fenomene dhe probleme të ndryshme në fushën e Hidroteknikës;
- Demonstrojnë një nivel të lartë të njohurive profesionale të fituara;
- Të aplikojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara për të planifikuar, projektuar, mbikqyrë dhe mirëmbajtë struktura të ndryshme hidroteknike;
- Të kenë konsideratë për çështjet e stabilitetit, sigurisë, mbrojtjes së ambientit dhe kostove financiare gjatë projektimit dhe ndërtimit të strukturave të ndryshme në fushën e Hidroteknikës;
- Të aplikojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara për të interpretuar aspektet sociale dhe kontekstet sociale të projekteve të realiuara
- Të gjejnë zgjidhje për probleme teknike dhe ambientale dhe të sqarojnë idetë dhe projektet e reja të gjithë ashkëpunëtorët e tyre;
- Në mënyrë të vazhdueshme të përcjellin inovacionet në shkencë dhe teknologji;
- Të jenë të gatshëm për pjesëmarrje në aktivitete multidisiplinare.

Fakulteti i Ndërtimtarisë u mundëson studentëve të të gjitha programeve mësimore studime me bursa në nivel bachelor, master dhe doktoratë. Të gjitha këto mundësi ofrohen në kuadër të bashkëpunimit shkencor të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me Universitete tjera ndërkombëtare. Nga këto programe bashkëpunimi për vazhdim të studimeve master, kanë përfituar edhe studentë të programit të studimit Hidroteknikë. Të gjitha mobilitetet e studentëve për avansime akademike janë të rregulluara përmes politikave të Universitetit të Prishtinës (Zyra për Marrëdhënie me Jashtë në kuadër të UP-së,; <https://www.uni-pr.edu/>).

Para fillimit të studimeve (në fillim të vitit të parë akademik) stafi menaxherial i fakultetit i mirëpret studentët duke ju shpjeguar të drejtat e tyre të siguruara me statutin e Universitetit, rregulloret e brendshme, orientimin e tyre me administratën.

Padyshim administrata e fakultetit luan rol të konsiderueshëm dhe është ndihmues i zhvillimit të procedurave administrative kur paraqiten rastet e nevojshme nga studentët për ndonjë kërkesë nga ana e tyre.

Kërkesat e studentëve parashtrohen në sekretarinë e fakultetit, të njëjtat i shqyrton komisioni për mësim në nivel të fakultetit dhe këto kërkesa janë të natyrave të ndryshme kryesisht çështje nga programet e studimeve (kohëzgjatja e afatit të studimeve, eventualisht shtyrja e ndonjë afati të provimit) nga ana e studentëve.

Komisioni i studimeve - komisioni për mësim raporton në këshillin e fakultetit me raport me shkrim dhe këshilli e miraton (komenton, me vërejtje, pa vërejtje, e refuzon) raportin.

Sistemi elektronik i menaxhimit të Studentëve SEMS, menaxhohet edhe nga stafi menaxhues i fakultetit, përkatësisht nga Dekani dhe Prodekani për çështje mësimore. Gjithashtu edhe administrata ka qasje më të zgjeruar në SEMS, me arsyen e vetme që të menaxhoj regjistrimet e semestrave për studentëve, certifikatat e ndryshme që kërkojnë studentët kohë pas kohe dhe sipas nevojës.

SEMS-i ruan regjistrat e regjistrimeve të studentëve nga fillimi i studimeve deri në përfundimin - diplomim.

Programi i studimeve për MSc Hidroteknike organizohet në gjuhën shqipe, kjo është e rregulluar edhe me Statutin e Universitetit të Prishtinës. Të gjitha lëndët ligjëratat, ushtrimet numerike/analitike, laboratorë i realizojnë në gjuhën shqipe. Secili bartës i lëndës ka për detyrë të siguroj literaturën primare në gjuhën shqipe (literatura e shtuar/zgjeruar mund të jetë në gjuhë tjetër, e që zakonisht në anglishte).

Puna e studentëve, përgjigjeje, punimet seminarike, punimet semestrale, detyrat projektuese, dhe diploma punohen në gjuhën shqipe.

Përgjegjësia bie mbi bartësin e lëndës që punimet e studentëve, diploma e tyre të jenë origjinale. Nuk ekziston ende ndonjë platforme elektronike me bazë në gjuhën shqipe që të bëhet vlerësimi i origjinalitetit të punimit, sikur janë në gjuhët tjera. Shpresojmë se në të ardhmen një gjë e tillë do të jetë e mundur (të krijohet platforma e origjinalitetit të punimeve).

Statuti i Universitetit është dokumenti i cili rregullon ligjërisht njësitë akademike, personelin akademik, administrativ dhe studentët. Në nivel të UP-së ekzistojnë rregullore të cilat rregullojnë dhe plotësojnë fushëveprimtaritë e veçanta për nevojat e Studentëve, studimeve të tyre dhe të tjera.

Kushdo, ka mundësinë që të qaset në web faqet e UP-së dhe të njësive akademike, përkatësisht të fakulteteve. Në web faqet janë këto rregullore të cilat edhe mund të shkarkohen. Kjo është një metodë shumë transparente e organizimit të veprimtarive akademike dhe se Studentët janë të njoftuar për detyrimet dhe të drejtat e tyre.

Në nivel të UP-së është rregullorja për mobilitet akademik të studentëve në Universitetin e Prishtinës, (<https://uni-pr.edu/desk/inc/media/BA831ED1-9509-4526-A221-5797F822601D.pdf>). Qëllimi i kësaj rregulloreje është respektimi i të gjitha standardeve të BE-së që orientojnë IAL drejt integritimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Hapësirën Evropiane të Hulumtimeve Shkencore, duke respektuar kartën e Bolonjës dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës për inkurajimin dhe promovimin e mobilitetit akademik dhe personelit.

Kjo rregullore është publike për studentët, në web faqe (sikur më sipër), dhe përmban obligimet dhe detyrimet, procedurat për mobilitet për njësitë akademike si dhe për studentët. Njohja e mobilitetit akademik është qështje e cila rregullohet në nivelin e fakultetit dhe programit të studimeve.

Stafi akademik i rregullt dhe ai i angazhuar ka detyrimet kontraktuale për mbajtjen e mësimi, çështjeve administrative si dhe konsultimeve me studentët.

Konsultimet me studentët janë të rregullta, ato edhe organizohen varësisht nga kërkesat e studentëve, para provimeve, pas provimeve, gjatë mësimi, gjatë punimit të diplomës, gjatë punimit të projekteve si dhe raste të hulumtimeve të veçanta.

Për t'u informuar rreth arritjeve shkencore, studentët kanë çasje në librarinë digjitale "Science Direct", të shtëpisë botuese Elsevier (ScienceDirect, Uebajti i UP-së: <https://www.uni-pr.edu/>). Poashtu, studentët kanë mundësi të gjejnë materiale elektronike edhe në Bilblotekën Qendrore Kombëtare përmes platformës LibApps të krijuar nga Universiteti i Prishtinës në kuadër të projektit Erasmus +, "Library Network Support Services".

## **Analiza SWOT për studentët:**

### **A. Pikat e forta:**

- Numër i konsiderueshëm i studentëve të interesuar për studim në programin studimor Hidroteknikë, niveli Master,
- Pjesëmarrje e studentëve të të dy gjinive, ekuilibri i gjinive në grupin e studentëve që aplikojnë për regjistrim,
- Studentët kanë mundësi të studiojnë me kurrikula që janë kompatible me kurrikulat ndërkombëtare të fushës,
- Marrëdhënie të mira ndër studentore,
- Shërbime më të mira studentore, duke iu falënderuar sistemit për menaxhim të studentëve (SEMS),
- Mundësia e studentëve të kenë qasje në revista shkencore përmes librarisë digjitale Science Direct të ofruara nga UP-ja.

### **B. Dobësitë:**

- Nuk vërehet ndonjë dobësi.

### **C. Mundësitë:**

- Zgjerimi i bashkëpunimeve me kompani lokale si mundësia e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve
- Mundësi e mobilitetit të studentëve,
- Inkurajimi i studimeve dhe edukimit të vazhdueshëm gjatë tërë jetës.

### **D. Sfidat:**

- Mbajtja në nivel e rolit të edukimit të lartë në shoqëri,
- Praktika ndërkombëtare për studentë.

#### **4.1.6. Hulumtimi**

Në përgjigje të gjendjes lokale dhe asaj globale si dhe në raport me çështjet kryesore që shtrohen sot për zgjidhje Universiteti i Prishtinës është përpjekur që nëpërmjet një procesi të gjatë reflektimi të përcaktojë dhe konsolidojë misionin e tij institucional dhe objektivat kryesore të zhvillimit të mëtejshëm. Gjithashtu edhe njësitë akademike në misionet e tyre kanë fushat e hulumtimeve çështje të hapur me prioritet. Konsolidimi dhe përparimi i kërkimit shkencor bazuar në metodat bashkëkohore dhe inovative është një nga objektivat kryesore të Fakultetit të Ndërtimtarisë.

Vizioni i Universitetit të Prishtinës dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë është që të vendoset një standard i ri i cilësisë për arsimin e lartë në Evropën Jugore. Për këtë qëllim, Universiteti i Prishtinës dhe Njësitë e tij Akademike kanë vendosur standarde të larta në mësimdhënie, hulumtime dhe punë krijuese për të gjithë mësimdhënësit. Fusha e hulumtimeve shkencore është çështje me prioritet. Poashtu edhe në Planin Strategjik të Universitetit të Prishtinës, nga tetë fushat strategjike të fokusit dhe iniciativës, fusha e parë është mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi.

Mësimdhënësit e përfshirë në programin e studimit Hidroteknikë janë të përzgjedhur përmes politikave të hartuara nga Universiteti i Prishtinës. Kjo do të thotë se, mësimdhënësit e përfshirë, përpos kritereve të tjera të kërkuara, plotësojnë edhe kriterin e publikimit të punimeve shkencore në revista ndërkombëtare, të cilat janë në pajtueshmëri me Udhëzuesin Administrativ mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension [A20, A21]. Hulumtimet e mësimdhënësve, mundësojnë sjelljen e kësaj eksperience hulumtuese edhe në klasë, me c'rast përfitonjë studentët. Hulumtimi është i pranishëm në studimet e nivelit Master edhe përmes punës hulumtuese të studentëve në laboratorët ekzistues nën mbikqyrjen e profesorëve [A38].

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar mësimdhënësit kanë realizuar vizita studimore dhe atë në: Universitetin Teknik të Vjenës, Austri; në Universitetin e Grazit, Austri; në Universitetin e Luevenit në Belgjikë, Universitetin e Shkupit, Maqedoni; në Universitetin Politeknik në Tiranë, Shqipëri etj.

#### **Analiza SWOT për hulumtim:**

##### **A. Pikat e forta:**

- Publikime të hulumtimeve shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare,
- Dukshmëria e publikimeve shkencore dhe aktiviteteve tjera hulumtuese, publikimet on-line,
- Statusi si institucion kryesor që grumbullon hulumtuesit dhe shkencëtarët e vendit,
- Qasje në revista shkencore përmes librarisë digjitale Science Direct të ofruara nga UP-ja.

##### **B. Dobësitë:**

- Decentralizim financiar për hulumtime të dedikuara të stafi akademik.

##### **C. Mundësitë:**

- Bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e hulumtimeve shkencore,
- Krijimi i mundësive për bashkëpunim më të mirë me sektorin e biznesit në vend,
- Lehtësimi i procedurave dhe rritja e efikasitetit të tyre për ofrimin e mbështetjes financiare,
- Rritja e përkrahjes financiare për hulumtime dhe publikime të stafit akademik.
- Investimi në laborator të Hidroteknikës, në kuadër të FN-së.

#### **D. Sfidat:**

- Promovimi i bashkëpunimit në mes të stafit akademik dhe profesionistëve të angazhuar në sferat tjera të fushës së Hidroteknikës,
- Zhvillimi i mundshëm i hulumtimeve përmes financimit vetanak apo përmes projekteve hulumtuese në të cilat duhet aplikuar,
- Rritja e detyrave të mësimdhënësve për shkak të sistemit të Bolonjës po e rrezikon zhvillimin më të fuqishëm të shkencës.

#### 4.1.7. Infrastruktura dhe burimet

Fakulteti i Ndërtimtarisë si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, aktivitetin e sajë akademik, mësimorë dhe administrativ e ushtron në “objekti i Teknikut” që gjendet në lokacion me adresë: rruga Agim Ramadani, pranë QKUK, Prishtinë.

Objekti i Teknikut, njihet si Fakulteti Teknik që lidhet me historinë nga e kaluara kur Fakulteti Teknik përbëhej nga njësitë akademike Ndërtimtari, Makineri dhe Elektroteknikë.

Në rastin kur njësitë marrin pavarësinë institucionale në kuadër të Universitetit të Prishtinës si:

Fakulteti i Ndërtimtarisë

Fakulteti i Inxhinierisë Elektroteknike dhe Kompjuterike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Atëhere, të tri Fakultetet si njësi të pavarura në mes veti funksionojnë në hapësirat e këtij objekti, i cili shpeshëhere identifikohet si objekti i “Fakultetit Teknik” dhe kohëve të fundit si “Kampusi i Teknikut”.

Lokacioni i “kampusit Tekniku” gjendet në pjesën jugore të qyteti të Prishtinës, në afërsi të tri lagjeve të banimit të qytetit të Prishtinës - Ulpiana, Bregu i Diellit dhe Mati 1 si dhe në anën jugore kufizohet me Qendrën Klinike Univesitare të Kosovës. Hapësira përfshinë një lokacion të pa përfunduar në pikëpamje të zhvillimit urban edhe pse e tërë rrethina tashmë është ndërtuar në tërësi. Sipërfaqja e lokacionit është rreth 87,000 m<sup>2</sup> ose 8.70 hektarë. Kufizimi me tri rrugë të rendit të lartë e bën lokacionin të ketë lidhje të lehta me përmbajtjet më të rëndësishme të qytetit me transport publik, por edhe në distancë optimale për këmbësorë.

Sipërfaqja bazë e ndërtuar aktualisht është 10,140 m<sup>2</sup> ose 11.6%. Një pjesë e lokacionit para ndërtesës së fakulteteve dhe ndërtesës së laboratorëve është e rregulluar me gjelbërim i cili shfrytëzohet nga studentët dhe qytetarët e lagjeve përreth. Para fakultetit, blloku ndërtimor i definuar me Planin Zhvillimor Urban në tërësi i dedikohet arsimit dhe shkencës.

E tërë zona përreth objektit është e pajisur me të gjitha shërbimet e infrastrukturës teknike – furnizimi me uje dhe kanalizimi, furnizimi me energji elektrike, shërbimet ngrohjes qendrore si dhe infrastruktura e telekomunikimeve.

Përmbajtja e hapësirave të “Objektit të Teknikut” janë, hapësirat e përbashkëta të komunikimit (korridorët, shkallët, tualetet dhe WC-të, biblioteka, depo etj.), Amfietatrot, Sallat e mësimit, kabinetet për mësimdhënësit, hapësirat e administrates, hapësirat ndihmëse dhe të tjera. Padyshim, hapësirat që plotësojnë më së miri procesin e mësimdhënies janë Labororet të cilat gjenden në afërsi të objektit të Fakultetit dhe kanë shtrirje të konsiderueshme në hapësirë.

Duke qenë tri njësi akademike (FN, FIEK dhe FIM) të UP-së në veprimtari në këto hapësira, edhe hapësirat ndahen në mënyrë proporcionale. Hapësirat që nuk mund të ndahen në mënyrë proporcionale në pronësi atëhere ato hapësira shfrytëzohen me rotacion proporcionalisht në kuptimin kohor. Sipërfaqja e objektit është 11455 m<sup>2</sup>, ndërkaq, labororet e elektroteknikës me 4205 m<sup>2</sup> dhe të ndërtimtarisë me 5650 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja totale që i takon Fakultetit të Ndërtimtarisë është rreth 9,468.33 m<sup>2</sup>.

Hapësirat që i takojnë Fakultetit të Ndërtimtarisë nga kjo ndarje proporcionale janë: niveli i objektit 500 me përmbajtje 9 salla të mësimit, 13 kabinete për stafin akademik, hapësira të



përbashkëta për komunikim – korridore, tualete, WC, depo Laboratori i informatikës etj. Në këtë nivel të objektit gjendet edhe biblioteka e Fakulteteve.

Në nivelin 400, janë hapësirat e përbashkëta të Fakulteteve – Hollet e mëdha, Tualetet, WC, depot etj. Pjesa më e madhe e administrates së Fakultetit, shërbimet e studentëve, Sekretaria, Dekanati – zyret e menaxhmentit si dhe Amfiteatrot (415 dhe pjesërisht 408) gjenden në këtë nivel. Në këtë nivel është hyrja kryesore për në objekt.

Në nivelin 300, janë sallat e mësimit, zyret e administrates së Fakultetit ku zhvillohet veprimtaria për shërbime të studentëve. Hapësirat e përbashkëta, korridore, shkallë, tualete, WC etj.

Në nivelin 700, janë kabinetet për stafin akademik, hapësirat e përbashkëta. Secili nga stafi akademik i rregullt në Fakultet posedon, kabinetin e tij, tavolinën e punës, pajisjet e domosdoshme për punë, kompjuter, printer, telefon. Ujin Brenda kabineteve të instaluar.

Shikur numrin e studentëve aktiv Brenda FN-së (numri total i studentëve në të gjitha programet e studimeve në FN) rreth 4000 në raport me sipërfaqen totale të objektit që i takon FN është 9468.33/4000 atëhere sipërfaqja e objektit për një student është 2.37 m<sup>2</sup> i cili është tregues i mire i performances.

Gjendja dhe kushtet teknike që “objekti i Teknikut” i ofron janë të tilla që (duke llogaritur kohën e shfrytëzimit të objektit nga fillimi i shfrytëzimit 1982 deri sot – 38vite) mesatarisht plotësojnë nevojat e punës për njësit tona akademike. Në 5 vitet e fundit janë realizuar koga investime në përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të punës. Vlenë të përmendet përmirësimi i ngrohjes, funksionimi i rrjetit të ngrohjes ndjeshëm ka kontribuar në përmirësimin e kushteve për mësimdhënje të rregullt në sallat e mësimit. Në vitin 2018 nga Investimet e Bankës Botërore, programi për efikasitet të energjisë, është investuar në fasadën termike dhe dritareve të objektit. Vit pas viti UP-ja investon pjesërisht në riparimin dhe funksionalizimin e hapësirave edhe të Objektit tonë. Në vitin 2018 janë bërë investime në rregullimin e ambienteve të Hapësirave në pjesën e objektit të Laboratoreve. Pjesa e Gjeodezisë si dhe Labororet tjera.

Për funksionimin e Laboratorëve, për nevojat e mësimit janë bërë investime kapitale në pajisjet për Labororet e Gjeomekanikës, Materialeve dhe asfaltit, Hidroteknikës dhe Inxhinierisë së Ambientit.

Edhe përkundër investimeve të bëra dhe që bëhen, pjesë të objektit nuk kanë mbërri të riparohet dhe do të ketë nevojë në të ardhmen që të bëhen riparime të mëtejme lidhur me hapësirat e objektit. Veçanërisht është e nevojshme dhe urgjent e ngutshme rritja e kapaciteteve të bibliotekës ose edhe eventualisht të ndërtohet objekti i sajë – biblioteka Teknike në të ardhmen.

Mirëmbajtja e objektit dhe hapësirave, sigurimi i tyre bëhet nga operator ekonomik të kontraktuar nga UP-ja. Për të tri fakultetet përkatësisht për tërë objektin mirëmbajtja bëhet e përbashkët.

Të gjitha departamentet e Fakultetit të Ndërtimitarisë i shfrytëzojnë hapësirat për mësim në mënyrë të përbashkët (hapësira të pa ndara). Për arsye të specifikave të punës, pajisjeve dhe dhërbimeve Labororet janë të ndarë në funksion të eksperimenteve që zhvillohen.

Të gjitha ambientet e Fakultetit janë të pajisura me shërbime të Internetit Wifi free.

## **Analiza SWOT për infrastrukturën dhe burimet:**

### **A. Pikat e forta:**

- Hapësirë e mjaftueshme për zhvillim të procesit mësimor,
- Hapësirë e mjaftueshme për krijim të laboratorit,
- Mundësi në librari digjitale ScienceDirect.

### **B. Dobësitë:**

- Hapësirë e pamjaftueshme për bibliotekë fizike,
- Mungesë e teksteve profesionale në bibliotekë,
- Mungesa e hapësirave për studim të pavarur nga ana e studentëve,
- Mungesa e hapësirave relaksuese dhe rekreacionale të studentëve.

### **C. Mundësitë:**

- Ndarja e hapësirës shtesë për rritjen e sipërfaqes së bibliotekës,
- Krijimi i hapësirave për mësim vetanak të studentëve,
- Krijimi i hapësirave relaksuese dhe rekreacionale brenda objektit të FNA-së.

### **D. Sfidat:**

- Sigurimi i fondeve për krijimin e laboratoreve përmes projekteve hulumtuese.
- Sigurimi i fondeve për zgjerim të bibliotekës ekzistuese,
- Sigurimi i fondeve apo investimeve për krijimin e hapësirave relaksuese dhe rekreacionale të studentëve.

## 5. LISTA E REFERENCAVE



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
 "HASAN PRISHTINA"  
 UNIVERSITY OF PRISTINA  
 FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY  
 Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë  
 Tel: +381-38-548 644      URL: <http://www.uni-pr.edu>      Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Dekani

Prof.Ass.Dr.Florim Grajçevci

Ref. nr. \_\_\_\_\_

Prishtinë \_\_\_\_\_ 2021

Për nevojat e hartimit të raporteve të vetëvlerësimit të brendshëm të riakreditimit të programeve të studimeve për BSc konstruktiv, BSc Gjeodezi, BSc Hidroteknikë, MSc Konstruktiv dhe MSc Hidroteknikë, në vazhdim janë të radhitura referencat të cilat ndihmojnë për faktet dhe mbështetjet të cilat Fakulteti i Ndërtimtarisë si njësi akademike e Universitetit të Prishtinës e bazon aktivitetin e vet.

### LISTË E REFERENCAVE - RAPORTI RVB

Referenca 1	Statuti i UP
Referenca 2	Monografia UP
Referenca 3	Plani Strategjik UP
Referenca 4	Kodi Etik I stafit akademik
Referenca 5	Marreveshje mes Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Fakultetit të Arkitektures
Referenca 6	Pershkrimi i Punës së Dekanit
Referenca 7	Rregullore për studimet Bachelor (BSc) UP
Referenca 8	Rregullore për studimet Master (MSc) UP
Referenca 9	Rregullore për plotësim ndryshim të nenit 25, paragr. 7 të Rregullores nr. 2-921, dt. 24.10.2019, për studimet themelore bachelor në Universitetin e Prishtinës
Referenca 10	Rregullore për plotësim-ndryshim të Rregullores nr. 2-922, dt. 24.10.2019, për studimet master shkencor në Universitetin e Prishtinës
Referenca 11	Vendim - Koordinator Florim Grajçevci
Referenca 12	Vendim - Koordinator Laura Kusari
Referenca 13	Vendim - Koordinator Figene Ahmedi
Referenca 14	Vendim - Koordinator Perparim Ahmeti
Referenca 15	Vendim - Koordinator i zhvillimit akademik Enes Krasniqi
Referenca 16	Vendim - Komisioni për studime në FN
Referenca 17	Udhezues për temën e diplomes Bachelor
Referenca 18	Udhezues për temën e diplomes Master
Referenca 19	Vendim për vazhdimin e afatit të diplomimit_BSc MSc dhe PhD
Referenca 20	Rregullore mbi emerimin, riemerimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2019
Referenca 21	Rregullore mbi emerimin, riemerimin dhe avancimin e personelit akademik UP 2018
Referenca 22	Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkpunëtorëve të jashtëm UP
Referenca 23	Raport i komisionit vlerësues për angazhim për bashkpunëtorë të jashtëm

Referenca 24	Deklarate mbi parandalimin e nepotizmit ne UP
Referenca 25	Rregullore e punes se sistemit elektronik per menaxhimin e studenteve SEMS
Referenca 26	Vendim - Caktimi i mbikqyresit te asistenteve te autorizuar per ligjerata
Referenca 27	Vendim - Emerimi i eksperteve per lenden e gjykates
Referenca 28	Vendim - Emerimi i komisionit per Ekuivalentim dhe Barazvlere te FN
Referenca 29	Miratimi i rregullores - Plotesim Ndryshimi i rregullores nr.163 15.1.2015 - Trupa Keshill-dhenese e njesive akademike UP
Referenca 30	CV Template e Stafit Akademik
Referenca 31	Kontrata e punes Template
Referenca 32	Kontrata per angazhim me honorar Template
Referenca 33	Kontrata per angazhim me mbinorme Template
Referenca 34	Rregullore per sigurimin e cilesise dhe vleresimit UP
Referenca 35	Kronika Kombetare e Kualifikimeve
Referenca 36	Udhezues per vleresimin e lendeve nga studentet dhe perdorimi i rezultateve te tyre ne UP
Referenca 37	Rregullore per proceduren e zgjedhjeve te studenteve
Referenca 38	Rregullore për Financimin e Veprimtarisë Kërkimore - Shkencore, Artistike dhe Sportive në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" 3-879, 11.12.2020
Referenca 39	Zgjatje e periudhes se akreditimit per programet e Studimit te UP - FN dhe FA
Referenca 40	Vendimi i Menaxherit të Kontrates dhe vendimi i Komisionit te Pranimit
Referenca 41	Njoftim per Kontratë - Furnizim me pajisje laboratorike per FIEK dhe te tjera
Referenca 42	Njoftim per Kontratë - Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve laboratorike per FNA-në
Referenca 43	Dosja e Tenderit- Shqip_Furnizim me paisje Laboratorike për FIEK dhe FNA
Referenca 44	Dosja e Tenderit-Shqip_Furnizimi dhe instalimi i paisjeve Laboratorike për FNA-së
Referenca 45	Kontrata dhe Oferta Financiare-Lot-2
Referenca 46	Kërkesa - Furnizim me paisje Laboratorike për FNA - Ritender
Referenca 47	Lista e Stafit Akademik_Hidroteknikë
Referenca 48	Lista e Stafit Akademik_Konstruktiv
Referenca 49	Planifikimi i prokurimit paraprak - buxheti per vitin 2021
Referenca 50	Kerkese rektoratit lidhur me buxhetin e vitit 2021, 22 nga FN, FIM, FIEK
Referenca 51	Kerkesat dhe Formularet
	Fleteregjistrim
	Kerkesat per studente
	Formulari F1B_Kerkese per caktimin e mentorit BSc
	Formulari F2B_Raporti per aprovimin, formimin e komisionit dhe mbrojtjen e punimit te diplomes BSc
	Kerkese per terheqjen e punimit te diplomes dhe vendimi per mbrojtje BSc

	Formulari F1_Kerkese per vleresimin e projekt propozimit te temes se diplomes MSc
	Formulari F1_Raporti i vleresimit te Projekt Propozimit MSc
	Formulari F2_Kerkese per Formimin e Komisioni per vleresimin e temes se Diplomes MSc
	Formulari F3_Raporti i vleresimit te temes se diplomes MSc
	Formulari F4_Formulari per mbrojtjen e temes se diplomes MSc
Referenca 52	Pyetesoret
	Pyetësor për personelin akademik Shqip
	Pyetësor për personelin akademik English
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës Shqip
	Pyetësori për vlerësimin e lëndës English
	Pyetesori per studentet e nivelit Bachelor Shqip
	Pyetesori per studentet e nivelit Bachelor English
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit Shqip
	Pyetësor për personelin administrativ dhe mbështetës të universitetit English
Referenca 53	Template, Certifikatë e trajnimit të stafit akademik
Referenca 54	Rregullorja për mobilitet akademik të studentëve në Universitetin e Prishtinës
Referenca 55	Buxheti i planifikuar 2021,2022,2023
Referenca 56	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 3
Referenca 57	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 4
Referenca 58	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 5
Referenca 59	Planimetria e objektit te fakultetit-Kati 7
Referenca 60	Suterreni-Labororet dhe Salla Mesimi
Referenca 61	Perdhesa-Labororet dhe Salla Mesimi
Referenca 62	Labororet dhe Salla Mesimi -Kati 1
Referenca 63	Learning agreement Student Mobility for Studies

## 6. SHTOJCAT

### 6.1. Studentët – të dhënat

Numri i studenteve aktual ne Programet e FNA-së

	Bachelor			Master			Gjithsej		
	total	F	M	total	F	M	total	F	M
<i>Konstruktiv</i>	635	121	514	108	19	89	743	140	603
<i>Hidroteknike</i>	186	41	145	50	18	32	236	59	177
<i>Gjeodezi</i>	208	44	164	48	18	30	256	62	194
<i>Inxhinieri e Ambientit</i>	101	68	33				101	68	33
<i>Infrastruturë Rrugore</i>				3	2	1	3	2	1
<b>TOTALI</b>	<b>1130</b>	<b>274</b>	<b>856</b>	<b>209</b>	<b>57</b>	<b>152</b>	<b>1339</b>	<b>331</b>	<b>1008</b>

Numri i studenteve dhe te diplomuarve ne tre vitet e fundit

KONSTRUKTIV	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentë	Të Diplomuar	Studentë	Të Diplomuar
	2016/2017	1358	81	238	3
	2017/2018	1404	74	280	16
	2018/2019	753	19	124	6
HIDROTEKNIKË	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentë	Të Diplomuar	Studentë	Të Diplomuar
	2016/2017	585	70	117	2
	2017/2018	599	36	130	0
	2018/2019	277	8	73	2
GJEODEZI	Viti	BACHELOR		MASTER	
		Studentë	Të Diplomuar	Studentë	Të Diplomuar
	2016/2017	627	33	112	0
	2017/2018	545	32	96	0
	2018/2019	289	9	56	0
	Viti			MASTER	

INFRASTRUKTURE RRUGORE			Studente	Të Diplomuar
	2016/2017		47	2
	2017/2018		34	2
	2018/19		14	1
INXHINIERI E AMBIENTIT	Viti	BACHELOR		
		Studente	Të Diplomuar	
	2016/2017	108	/	
	2017/2018	98		
2018/2019	154	5		

Numri i studenteve qe i braktisin studimet (drop-out) për tri vitet e fundit

Niveli i studimeve	2015/16	2016/17	2017/18
Niveli Bsc	30	29	13
Niveli Master	2	2	0
Niveli PhD			

## 6.2. Hapësirat dhe paisjet

	DESTINIMI I HAPËSIRËS	SASIA	SIPËRFAQJA (m2)
1	SALLA MËSIMI	19	1200
2	LABORATORET	7	1268
2'	Hapësira përcjellëse të laboratoreve (kabinet, sallë mësimi* dhe depo)	6*	1589
3	KABINETE	26	379
4	ADMINISTRATA	8	182
5	Laboratorë kompjuterash	3	240
6	Korridore + nyje sanitare + hapësira ndihmëse+ nyje sanitare shtese		2397
	<b>GJITHSEJ SIPERFAQE PER DEPARTAMENTET NE OBJEKTIN E FAKULTETEVE TEKNIKE DHE LABORATORE</b>		<b>7255 m2</b>

	PAJISJET	SASIA	

1	PROJEKTORËT	24	
2	MJETET E KONKRETIZIMIT	54	
3	APARATURA LABOATORIKE (I-materialet)	150	
4	APARATURA LABORATORIKE (II-asfalti)	32	
5	APARATURA LABORATORIKE (Hidroteknikë)	20	
6	APARATURA LABORATORIKE (Master në Gjeodezi)	40	
7	APARATURA LABORATORIKE (Eficienca e Energjisë)	20	
8	APARATURA LABORATORIKE (III-Gjeomekanike)	70	

	<b>LIBRAT</b>	<b>SASIA</b>	
1	REGJISTRI FIZIK I LIBRAVE	2	
2	REGJISTRI ELEKTRONIK I LIBRAVE	2	

	<b>INFRASTRUKTURA E IT</b>	<b>SASIA</b>	
1	INTERNET (WI FI)	All areas	
2	NUMRI I PC PËR STAF AKADEMIK	50	
3	NUMRI I PC PËR STUDENTË	95	
4	NUMRI I PC PËR ADMINISTRATË	20	
5	WI FI	Ne te gjitha hapesirat	
6	PRINTERA	50	
7	TELEFONA FIKS	6	
8	APARATET FOTOKOPJUESE	3	



### 6.3. Plani i Buxhetit dhe financimi per FN DHE FA

Plani i buxhetit dhe i financimit (llogaritë e të hyrave, shpenzimeve kapitale, shpenzimet per hulumtime dhe shpenzimet per mjete te konkretizimit) ne nivel te Njesisë akademike/Institucionit ne përgjithësi, për së paku tri vitet e ardhshme:

PERSONELI /PAGAT DHE MEDITJET	Numri i Punëtorëve të Aprovuar 2019	Planifikimi i Buxhetit për 2020		Planifikimi i Buxhetit për 2021		Planifikimi i Buxhetit për 2022	
Profesor i rregullt	5	7	267,201	8	293,921	9	323,314
Profesor i asocuar	8	8	119,924	9	131,917	10	145,108
Profesor asistent	15	17	75,892	18	83,481	19	91,829
Ligjerues	1	1	24,045	2	26,450	3	29,095
Asistent	18	20	286,287	21	314,915	22	346,407
Administrate	11	12	109,147	13	120,061	14	132,067
Bashkepuntore	28	30	416,782	31	458,460	32	504,306
<b>TOTALET E STAFIT DHE SHPENZIMEVE PËR PAGA &amp; MËDITJE</b>	127	95	<b>1,299,278 €</b>	102	<b>1,429,206 €</b>	109	<b>1,572,126 €</b>

SHPENZIMET NE KATEGORITE TJERA EKONOMIKE	Planifikimi i Buxhetit për 2020	Planifikimi i Buxhetit për 2021	Planifikimi i Buxhetit për 2022
MALLRA E SHËRBIME	448,270	473,097	520,407
SHPENZIME KOMUNALE	77,000	84,700	93,170
SHPENZIME KAPITALE	1,705,700	1,876,270	2,226,270
<b>TOTALET E SHPENZIMEVE NË KATEGORITË TJERA EKONOMIKE</b>	<b>2,230,970 €</b>	<b>2,434,067 €</b>	<b>2,839,847 €</b>
<b>SHPENZIMET TOTALE DHE STAFI</b>	<b>3,530,248 €</b>	<b>3,863,272.86 €</b>	<b>4,411,973 €</b>

#### **6.4. Struktura e Aneksëve të bashkelidhura në format elektronik (për verzionin final të RVV-se në CD)**

**UP-FN-2021** (*Folder-i kryesor*)

##### 1 Dokumente

01-Aneks-Faqja e parë-Aplikacioni

02-RVV-UP-FN-riakreditim

03-Aneks-FN-Plani i zbatimit të rekomandimeve

04-Aneks-Puna dhe Projektet shkencore

05-Aneks-Marreveshje Bashkëpunimi

06-Aneks-Lista e referencave

##### 2 CV

CV-MSc Konstruktiv (*të gjitha CV-të e Personelit mësimor në Program*)

CV-MSc Hidroteknikë (*të gjitha CV-të e Personelit mësimor në Program*)

##### 3 Syllabuse

Syllabuse- MSc Konstruktiv (*të gjitha lëndëve në Planin mësimor të Programit*)

Syllabuse- MSc Hidroteknikë (*të gjitha lëndëve në Planin mësimor të Programit*)